ExLibris

ISSN 2708-4876

E PËRJAVSHME LETRARE KULTURORE

Themelues • Kryeredaktor BUJAR HUDHRI

E SHTUNË, 21 NËNTOR 2020. NUMËR 106. VITI II I BOTIMIT. ÇMIMI 50 LEKË. WWW.EXLIBRIS.AL EMAIL: INFO@EXLIBRIS.AL BOTIM I ONUFRI SHPK

Nesër shënohet 112 vjetori i mbylljes së punimeve të Kongresit të Manastirit në të cilin u vendos edhe alfabeti që përdorim sot. Diskutimet rreth asaj që ndodhi aty janë të shumta. Ishin disa alfabete që përfliteshin dhe dakordësimi për unifikimin e gjuhës nën një të vetëm ishte thuajse i pamundur. Në përfundim, u vendos që të përdoreshin zyrtarisht dy alfabete, në të tillë mënyrë që koha të mënjanonte cilin të ishte më i papërshtatshëm. Por autorësia e alfabetit që përdorim akoma edhe sot, si dhe përzgjedhja e grafemave që i përgjigjeshin fonemave të gjuhës, vijon të mbetet temë diskutimi. Sigurisht, ne nuk pretendojmë ta zgjidhim përfundmisht atë, por të paraqesim për lexuesin një debat të hapur në vitin 1943 në shtypin shqiptar.

KUSH E HARTOI ALFABETIN E GJUHËS SHQIPE?

(Diskutimi në të përkohshmet "Kumbona e së Diellës" dhe "Hylli i Dritës")

Përgatiti Andreas Dushi



Mbi romanin "Pëllumbat i vrasin natën" të Virion Graçit

ALEGORIA E HISTORISË DHE REALITETIT

Sali Bashota (fq. 12)

(Intervistë e shkrimtarit Besnik Mustafaj botuar me 10 tetor në suplementin kulturor të gazetës së madhe arabofone Al Araby, që del në Londër dhe shperndahet në mbarë botën.)

BESNIK MUSTAFAJ: Dhimbja njerëzore është një dhe e vetme

(fq. 10)

Vlora Nikçi, *Kangë popullore erotike*

NGASJA EROTIKE NË POEZINË POPULLORE

Shaban Sinani (fq. 7)

Në botimet që mbledhësit e folklorit, individë e institucione, i kanë bërë lirikës popullore, *eros*-i nuk ekziston. Përmes një termi tinëzar, *lirikë dashurie, këngët mirëfilli erotike janë lënë jashtë...*

"Enciklopedia e mërgimit" me autorë Entela Tabaku, Shqiptar Oseku

TË JETOSH ME NJË "PËRBRI" BRENDA TEJE

nga Ballsor Hoxha (fq. 8)

Përmbledhja me poezi "Enciklopedia e mërgimit" është poezi si gjendje, si asnjanësi, si jetë prapa çarjes së saj në dy pjesë. Ku nuk arrin të kalosh kurrë matanë, as në vendin mikpritës e as në vendin e lindjes...

- Botohet në Rumani romani "Funerali i pafundmë" i shkrimtarit Visar Zhiti –

KORTEZH NËN PANDEMINË IDEOLOGJIKE

Romani „Funerali i pafundmë" është një udhëtim absurd i kortezhit terratisës pa një vendmbërritje, një sfidë e vazhdueshme e durimit sfilitës njerëzor në ballafaqimin me realitetin e brendshëm shpirtëror... (fq. 11)

EUDORA WELTY

Si më krijuan prindërit një fëmijëri me libra

(fq. 18)

GIUSEPPE UNGARETTI

Ndjenja e kohës

Përktheu nga origjinali: Aida Baro (fq. 14)



(fq. 11)

BIBLIOTEKË

Nadine Gordimer *Përpara krismës së pushkës* (fq. 17)

Xhelal Tosku *Hëna hyn në dhomën time* (fq. 16)

Thoma Note *Galja* (fq. 15)

(*Mallkimi i priftëreshave të Ilirisë* të Mira Meksit)

PIRATERIA NË QENDËR TË DISPOZITIVIT NARRATIV

nga Alketa Spahiu (fq. 5)

Nesër shënohet 112 vjetori i mbylljes së punimeve të Kongresit të Manastirit në të cilin u vendos edhe alfabeti që përdorim sot. Diskutimet rreth asaj që ndodhi aty janë të shumta. Ishin disa alfabete që përfliteshin dhe dakordësimi për unifikimin e gjuhës nën një të vetëm ishte thuajse i pamundur. Në përfundim, u vendos që të përdoreshin zyrtarisht dy alfabete, në të tillë mënyrë që koha të mënjanonte cilin të ishte më i papërshtatshëm. Por autorësia e alfabetit që përdorim akoma edhe sot, si dhe përzgjedhja e grafemave që i përgjigjeshin fonemave të gjuhës, vijon të mbetet temë diskutimi. Sigurisht, ne nuk pretendojmë ta zgjidhim përfundmisht atë, por të paraqesim për lexuesin një debat të hapur në vitin 1943 në shtypin shqiptar.

KUSH E HARTOI ALFABETIN E GJUHËS SHQIPE?

(Diskutimi në të përkohshmet "Kumbona e së Diellës" dhe "Hylli i Dritës")

Përgatiti Andreas Dushi

Në numrin 8 të vjetit V, datë 22 Fëruer (Shkurt) 1942, e përjavshmja *Kumbona e së Diellës* çelet me kryeartikull «Emzot Prengë Dochi» të shkruar nga Dom Nikollë Sahatçia. Me detaje, ai tregon jetën dhe veprën e klerikut e gjuhëtarit të shquar. Mes të tjerash, thotë:

Në vjetin 1899, bashkë me Dom Ndoc Nikajn, themeloi ma të paren shoqni letrare në Shkoder, shoqnin "Bashkimi". Kjo shoqni i dha shkas të madh zhvillimit të gjuhës shqipe që Dera e Stambollit donte m'e zhdukë, kurse ndalote çdo botim në ket gjuhë e dënote randë autorin, e veç toleronte botimet me subjekt fetar. Prandej Emz. Dochi kësaj shoqnie i dha ngjyrë fetare, e pjestarët e saj i zgjodh prej klerit: françeskaj e priften. Posë librave të botuem, prej kësaj shoqnie kemi Alfabetin që Kongresi i Manastirit, mbajtë në Nanduer 1908, e miratoi, duke i bâ pak ndryshime.

Pra, sipas Sahatçisë, është pikërisht alfabeti i shoqërisë "Bashkimi" ai që u zgjodh nga Kongresi i Manastrit për të qenë alfabeti i gjuhës shqipe.

Paraprakisht, le të sqarojmë pak si u krijua kjo shoqëri. Në parathënien e ribotimit të *Fialuer i Rii i Shqypes, Perbâam prêie Shocniiet t'Bashkimit*, (Botimet Fishta, 2018), Nikë Ukgjini citon Dom Ndoc Nikajn i cili, si dëshmitar i kohës, flet se si kjo shoqëri zë fill në vitin 1893 kur bëhet një takim mes Doçit dhe disa klerikëve:

[Shoqëria Bashkimi] *kishte për detyrë Bashkimin e Shqyptarve pa dallim feje dhe fisi... U lidhme me shkrue në giuhen shqype, seicili si mbas andjes së vet dhe si mbas prirjet përkatëse.*

Në vitin 1899, kjo shoqëri merr formën e vet zyrtare nën emrin "Bashkimi". Në takimin themelues të saj ishin: Imzot Preng Doçi, Imzot Lazër Mjeda, Dom Jak Sarreqi, Atë Gjergj Fishta, Dom Ndoc Sheldia, Dom Gjon Koleci, Dom Mark Shllaku, Atë Pashko Bardhi, Dom Ndoc Nikaj, Dom Dodë Koleci, Dom Mëhill Çuni, Mati Logoreci, Gasper Beltoja dhe Ndue Paluca. Kryetar i saj u zgjodh Preng Doçi.

Për t'u rikthyer te tema e alfabetit, po në *Kumbonën e së Diellës*, pak muaj më vonë, përkatësisht më datë 17 Mâjë 1942, numri 20, Gjon Ujka nën pseudonimin *Lul Shkurti* shkruan një artikull me titull *Shênjime rreth* ***alfabetit***.

Ai kundërshton pohimin e Sahatçisë duke thënë:

I vlerti D. Nikollë Sahatçija n'artikullin kujtimuer që ka botue në "Kumbonë" nr. 8 permbi atdhetarin e madh Imz. Prengë Doçin, paraqet pohimin se alfabeti që na përdorim sod nuk âsht tjeter, por ai i "Bashkimit" të cilin Kongresi i Manastirit e miratoi me pak ndryshime.

Âsht një gabim në të cilin pa dashtë bjen shumëkush, ky që me kujtue se alfabeti i "Bashkimit" kje ai që, me pak ndryshime, u pranue prej Kongresit të Manastirit i cili i dha fund çështjes atëherë aq të vshtirë t'alfabetit tue adoptue dy alfabetna, prej të cilit i dyti âsht ky që na kemi sod, por që qyshë atëherë u parashifte se do të mbetej i vetmi në përdorim të përgjithshëm. Prandaj, mbasi faktet historike shumë herë harrohen, besoj se nuk âsht keq me kërkue e me pa se çka alfabeti i sotshëm kâ marrë e çka kâ lânë prej atij të "Bashkimit".

Para se të vijojmë, të shohim cilat janë shkronjat e alfabetit të "Bashkimit", marrë nga faqja VII e *Fjalorit* të hartuar prej shoqërisë në fjalë:



DO OROE

permi shkroié e théksa

Shkroiét e giuhes shcypé iâne triidhéte e kater: a, b, c, ch, d, dh, e, f, g, gh, gn; h, i, k, l, ll, m, n, nn, o, p, r, rr, s, sh, t, th, ts, v, u, (*) y, x, xh, z.

Shkroiét a, e, i, o, u, y, iâne xântoré.

Shkroia e paa thékse hiédhse si t' mos ieet n' fillim t' fiales, a m' gnirroktsa nuk shcyptohét. Iosè fort leet kuur t' ghinnét mrênne n' fiale, e n' marim t' ksaie kurr, sikursé: *atehere, perhere, pûne, burre*, etr.

Bazuar në këtë, Ujka argumenton:

Tue lânë jashte germat që i kanë të perbashkëta me të tjerë dy alfabetat, një shqyrtim i këtyne ka me na diftue se n'alfabetin e sotshëm gjinden vetem pesë germa t'atij të "Bashkimit", d. m. th. ***dh, ll, th, sh*** *e* ***rr.*** *Perkundra janë lânë jashtë prej si dymbedhetë germa me vlerë fonetike që këto kishin n'atë alfabet... Në vênd të germave të perjashtueme prej atij të "Bashkimit", alfabeti i Manastirit mori shtatë prej atij të "Stambollit" e të "Agimit"... e pesë të tjera i shtîne së parit në perdorim.*

Duhet thënë se *Shoqria e Stambollit*, e njohur ndryshe si *Shoqëria e të Shtypurit Shkronja Shqip* u themelua më 12 tetor 1879 në Stamboll nga disa intelektualë shqiptarë si Sami Frashëri, Pashko Vasa e të tjerë, ndërsa *Agimi* "lindi" nga gjiri i *Bashkimit* kur dy vëllezërit Mjeda, Imzot Lazri dhe dom Ndreu u shkëputën duke krijuar shoqërinë e tyre letrare.

Por pse ndodhi kjo shkëputje?

Është shkruar shumë rreth kësaj teme, ama studiuesi më pasionant i jetës dhe veprës së dom Ndre Mjedës mbetet Mentor Quku me dhjetë vëllimet kushtuar personalitetit të tij. Në të tretin, ai flet gjerë e gjatë për këtë temë duke cituar njerëz që dëshmuan gjithë çfarë ndodhi, mes tyre edhe vetë Imz. Doçin që, në një letër dërguar Golluhskovit më 11 gusht 1903 shkruan:

Dom Ndre Mjeda, i liruar prej shoqërisë Jezuitëve, qe vendosur në Abacinë e Mirditasve prej meje, kryesisht që talentin e vet t'ia konsakronte kësaj shoqërie letrare [Bashkimit]. *Por ai, që më përpara kishte deklaruar se është gati të sakrifikojë edhe opinionet e tij private për dëshirat e mija, u shfaq kundërshtar në mbledhjen e parë (qershor 1899) në të cilën qe ftuar si anëtar i saj, pasi pa se nuk arrinte t'ia ndryshojë programin veçanërisht lidhur me alfabetin e saj ose të shkëpusë pjesëtarët e saj nga qëllimi për ta mbajtur.*

Më pas, ai citon Dr. Ranzin i cili në raportin e tij për Doçin thotë:

Mbledhja tjetër e "Shoqërisë për unifikimin e gjuhës shqipe", u bë... Përveç Dom Andrea Mjedës, që u shkëput nga shoqëria, të gjithë anëtarët e tjerë u solidarizuan plotësisht me mënyrën e re të shkrimit duke hequr dorë nga pretendimet apo vërejtjet e tyre të mëparshme.

Deri tani, del se arsyeja e vetme e shkëputjes së Mjedës nga "Bashkimi", ishte çështja e alfabetit. Tani le t*ë* shohim se kur dhe si z*ë* fill "Agimi" duke përmendur një letër të Atë Pashko Bardhit dërguar Mid'hat Frashërit n*ë* vitin 1929, marr*ë* gjithashtu prej po të njëjtit libër:

Kundërshtari ma i pari e ma i madhi i alfabetit të Bashkimit ka kenë Dom Ndre Mjedja. Ky, në të dytën mbledhje, në të cilën së parit muer pjesë si pjesëtar i Bashkimit, ju kundërshtue alfabetit, e lypte një alfabet me sheja diakritike. Pak mbrapa kje ba ipeshkëv Dom Lazer Mjedja, i cili filloi me mbështetë vllaun e vet Dom Ndren, e bashkë me t'Emzot Prend Biankun, kryeipeshkvin e Durrcit e me t'Emzot Pashko Trokshin kryeipeshkvin e Shkupit, bane në mnyrë që t'u bate në Shkodër një mbledhje ipeshkvijsh, për me caktue një alfabet të pergjithshëm për Gegni. Se i cili ipeshkv muer me vedi në këtë mbledhje ka një meshtar... Në këtë mbledhje, Dom Ndre Mjedja propozoj alfabetin e vet kundra atij të Bashkimit, e kështu bani edhe Dom Gasper Jakova. Mbledhja u shpernda, pa marrë një farë vendimi. Atëherë Bianku, Trokshi e L. Mjedja u mblodhen në Nenshat,... e ktu pranuen alfabetin e Ndre Mjedjes e themeluen shoqninë Agimi. Kta ndodhí në vitin 1901.

Tani le të rikthehemi sërish te shkrimi i Ujkës rreth çështjes së alfabetit:

Prandaj shifet kjartë se tue u pranue prej shtatëmbëdhjetë germave, vetem pêsë t'alfabetit të "Bashkimit" e tue u perjashtue dymbëdhjetë, nuk ka si thohet se ky i sotshmi nuk âsht tjeter veçse i pari me pak ndryshime.

Sikurse âsht dëshmue prej pjestarëve të Kongresit, alfabeti i sodshem âsht veper e D. Ndre Mjedës i cili, në mes t'antithesave të ndryshme që u shfaqne në gji të Kongresit, që ishin duke vue në rrezik të mbërrijtunin e qellimit të tij..., ja doli në krye të qellimit tue propozue alfabetin e sodshëm, i cili u pranue prej Kongresit..., pa kurrnji ndryshim.

Alfabeti i "Bashkimit", sikurse e thekson edhe i ndritëshmi gjuhëtar Atë Justin Rrota O. F. M. në veprën e vet të çmueshme "Për historin e alfabetit shqyp", nuk ishte i themeluem mbi baza shkencore...

Artikulli, mandej, vijon duke treguar e shpjeguar tipare të alfabetit që përzgjodhi Kongresi dhe duke vënë në dukje ndonjë mungesë të tij. Por nuk është ky objekti i këtij shkrimi.

1. Gjergj Fishta 2. Midhat Frashëri 3. Luigj Gurakuqi 4. Gjergj Qiriazi 5. Dom Ndre Mjeda 6. Grigor Cilka 7. Dhimitër Buda 8. Shahin Kolonja 9. Sotir Peçi 10. Bajo Topulli 11. Nyz'het Vrioni. Foto nga Kel Marubi

Në *Hylli i Dritës*, vjeti 1942, numri i mars - prillit, Atë Pashko Bardhi boton një artikull, gjithashtu për Doçin. Mes të tjerash, në faqen 129 – 130, ai shkruan:

Në Pjesën e dytë të "Zanit të Shna Ndout", un kam botue do shenjime historike mbi alfabetin e gjuhës shqype, në numrin e Qershorit 1920, faqe 153 – 155 kam shkrue mbi shoqnitë letrare "Bashkimi" e "Agimi" e mbi kongresin e Manastirit gjânësisht njashtu si jam tuj shkrue sot. At herë, në mos të gjith, nemose shumica e atyne që kanë marrë pjesë në kongres të Manastirit, kanë kênë gjallë, e gjallë ka kênë edhe D. Ndre Miedia. E asnjë nuk âsht *gjetun që u ka kundershtue fjalvet të mija, pse të gjithë e kanë dijtë se un tjetër së kam bâ, veç kam kallxue të verteten. E tash, mbasi kanë kalue 33 vjetë çë se* âsht *mbajtë kongresi i Manastirit..., po ka asish të cilët, tuj shtrembnue të verteten historike, duen me i kallxue rrjedhjet e punvet në kongres të Manastirit krejt ndryshe se kanë kênë në realitet. Këta do me thanë: I zoti e jep, e tellalli s'e jep.*

Kjo pjesë e shkrimit mbyllet me një pohim interesant i cili, kundërshtisë me nota të forta i jep një sens të lehtë dashamirësie. Por më përpara, le të lexojmë se për çfarë artikulli flet Atë Bardhi:

I botuar në "Zani i Shna Ndout", shkrimi mban titullin *Shoqnija e "Bashkimit" e shoqnija e "Agimit"*. Në të, mes të tjerash, tregohen dallimet mes këtyre dy shoqërive, librat që u botuan me alfabetin e njërës dhe të tjetrës. Sipas tij, ndasija mes tyre qëndronte në një pikë:

Pak mbrapa kundra shoqnijet të "Bashkimit" kje themelue shoqnija e "Agimit". Kundërshtimi i "Agimit" ishte të përdorumet e shkronjave me shejë në vend të shkronjave të dyzume, e kështu n'alfabet t'"Agimit" ishin nandë bazhkëzanore me shejë siprit.

Në vijim, kur flet për çështjen e *Kongresit* të *Manastirit*, Bardhi thotë:

...Për këtë arsye, atdhetarët e zgjedhun në komision, e panë me udhë që për gjuhen shqype t'u përdorojshin dy alfabeta: i Stambollës e i "Bashkimit" me ato ndryshime që përdorohen sot.

Dom Ndre Mjeda përmendet vetëm si përfaqësues i *Agimit* në *Kongres*, pa iu dhënë asnjë meritë e atillë sikurse është ajo që pretendon Ujka.

Për t'u rikthyer te shkrimi i Atë Bardhit në *Hyllin e Dritës*, në mbyllje ai thotë:

Emzot Doçi e D. Ndre Miedia kan kênë dy burra e dy atdhetarë të ndershem e, ndonse kundershtarë në çashtje t'alfabetit – të dy – gjithcili simbas pikpamjet të vet – kanë punue per të mirë t'atdheut. Por gjithcili ka meritimet e veta e nuk âsht *nevoja me marrë lavdet e njênit e me ja mbështetë tjetrit.* ***Unicuique suum.***

...Kurrkush nuk mundet me e mohue se D. Ndreu ka kênë një nder shkrimtarë e vjershtarë mâ të mirë që ka pasë Shqypnija. Pra i mjaftojnë lavdet e veta e s'ka nevojë per të huejat, të cilat, po t'ishte gjallë – si burrë me karakter që ka kênë – ai vetë nuk kishte me i pëlqye.

Na të gjithë punojmë me një program: "Fe e Atdhe". Por çdo polemikë që bâhet sot mbi ket çashtje krejt të pavend e të panevojshme, veç dâm se kurrfarë dobije s'i bje as fesë e as atdheut.

Me sa duket, Ujka këtë shënim e ka marrë sikur i drejtohej atij, prandaj, sërish në *Kumbona e së Diellës (vjeti 5, nr. 34, fq. 410 - 411)* boton një shkrim, me po të njëjtin titull si i pari: *Shênjime rreth* ***alfabetit***:

Një artikull i vogel i imi me të njajtin titull botue në "Kumbonen e së Diellës"... paska tërhjekë oroen e të ndertit Atë Pashko Bardhit i cili, ndonëse tërthuer e pa më emnue, më ka nderue me një përgjegje nder fletët e "Hyllit të Dritës"...

Pasi citon çfarë Bardhi ka shkruar, vijon:

Këto fjalë t'Atë Pashkos nuk kanë se si me i u shkrepë tjeter sendit, por njatij pohimit të paraqitun prej mejet n'artikull se: alfabeti i sodshëm âsht *veper e D. Ndre Mjedës. Por, tue më bâ mue një padi kaq të randë, se kam shtrembnue të verteten historike, ishte lypë që Atë Pashkja të kishte diftue njikohësisht se kush kje, mbas tij, autori i alfabetit. Pse këtu nuk e kemi* çâshtjen *se kush e mori iniciativën për të përbâm alfabetin, as kujt i shkoi meritimi për përpjekjet e bâme që lumnisht ja mbërriten qellimit të pranimit të tij, por të pyetunit që bâhet asht:* ***kush e hartoi alfabetin****?*

Pasi shtron këtë pyetje, Ujka thotë se nuk mund të jetë "një komision" *pse*, sipas tij, *veprimi njerëzor nuk mundet me pasë një kavi impersonale,* ***actiones sunt suppositorum***. Ai vazhdon t'i mëshojë idesë se është pikërisht Dom Ndre Mjeda hartuesi, tanimë duke dhënë një fakt i cili mund të mos jetë bindës, por është mjaft interesant:

Por unë pohimin se hartuesi i alfabetit asht Dom Ndreu nuk e kam trillue prej vedit. Tue lânë në njanen anë çka kam mujtë me ndî edhe prej pjestarëve të tjerë të Kongresit, unë pohimin e treguem e kam ndî shi prej gojës së Dom Ndre Mjedës, i cili, në një rasë, formalisht ka deklarue se alfabetin e Manastirit e ka hartue ai rrokull punimeve të Kongresit, e se ky alfabet i paraqitun prej tij, kje pranue prej komisionit e prej Kongresit pa kurrnjë ndryshim.

Sipas Gjon Ujkës, nuk ka qenë vetëm ai personi i cili e ka dëgjuar këtë deklaratë; kanë qenë edhe të tjerë, emrat e të cilëve nuk thuhen:

Ket deklaratë të Dom Ndreut e kanë ndî edhe të tjerë sikurse unë. Pra nuk asht rasti kur: i zoti e jep e tellalli s'e jep, por asht tellalli që bâhet jehona e fjalës së të zotit.

Duke u bazuar edhe në pohimin e Atë Bardhit për karakerin e Mjedës, Ujka vijon:

Pohimi i bamë prej Dom Ndreut lypet të besohet pa tjeter, sepse, si e thekson edhe Atë Pashkja vetë, Dom Ndre Mjeda ka kênë një burrë i ndershem e me karakter, e përveç kësajë, ka kênë edhe një Meshtar katholik shembulluer në të cilin posë virtyteve tjera, ka spikatë ai i përvujtnisë, e pra kishte me kênë absurd me mendue se ai ka bâ një deklaratë të rrêjshme tue i mveshë vedit një meritim që s'do ta kishte.

Ujka e di se një deklaratë e tillë ngjan e pabesueshme pasi, sikurse thonin latinët, *verba volant, scripta manent*, ndaj shkrimi i tij vazhdon:

Mundet me kênë se ndoshta nuk ka me u besue dëshmia e jême prej Atë Pashkos ose kujtdo kjoftë. Ani çka. Detyra e jême e e të tjerëve si unë, âsht *gjithmonë me dhanë dëshminë ma të plotë e formale për çka kemi ndî prej Dom Ndreut.*

Puna pse Dom Ndre Mjedja ket deklaratë nuk e ka bâ me të shkrueme sa kje gjallë, nuk provon kurrgja. Përveçse ai nuk ishte një reklamist i veprimtarive të veta, çashtja se kush asht kênë hartuesi i alfabetit nuk asht çilë asnjë *herë, e nuk asht gjetë kurrë kush që me i thanë Dom Ndreut: Alfabetin e kam hartue unë e jo ti. Prandej nuk ka kênë nevoja me bâ një pohim që asht kenë i dijtun e i pranuem prej pjestarëve të Kongresit sa ishin gjallë. Vetem në një rast të posaçëm që asht paraqitë, e ka ba gojas deklaraten e naltregueme, tue theksue se po e thote jo për me i bâ një lavd vetvedit, por sa me u dijtë.*

Pra, tanimë kemi një dëshmi të supozuar nga Dom Ndre Mjeda se ka qenë ai hartuesi i fjalorit. Duhet kuptuar qartë, jo ai që ka krijuar shkronjat, pasi shkronjat e alfabetit të *Agimit* janë me shenja diakronike dhe jo dyshe, sikurse qe ai që u vendos nga *Kongresi*, por ai i cili ka "përzgjedhur" grafemat për t'iu përgjigjur fonemave të shqipes.

Në periodikët e asaj kohe, mund të lexoje shpesh për këtë temë. Por pse ajo ka hapur dhe vijon të hapë diskutime akoma dhe sot? Le të bëjmë një udhëtim të shkurtër kronologjik në ditët kur u mbajt *Kongresi*, duke u bazuar në raportin e bërë gjatë gjithë ditëve që ai zgjati, botuar në numrin special të revistës *LEKA* me rastin e XXV – vjetorit të pavarsisë, datë 28 nëntor 1937, fq. 350 – 363.

Si fillim flitet për dy ditët e para të *Kongresit* kur prezantohen delegatët dhe bëhet e qartë arsyeja përse ishin mbledhur. Secili jep mendimin e vet për çështjen e alfabetit, dikush duke kërkuar të përdorej ai i *Stambollit*, dikush i *Agimit* e dikush i *Bashkimit*. Ditën e tretë duket se merr udhë fundi i një moskuptimi dhe fillimi i punës serioze në këtë drejtim:

Dit' e tretë

Manastiri këtë ditë u gdhi i bardhë prej dëborës. Kjo ish një shënjë që edhe delegatët do të dalin faqebardhë prej kongresit, dhe ky mejtim do t'ish në të tërë delegatët se e pamë që të ftohtët dhe të lagëtit e kohës dimënore nuk ua pakësoj as fare dëshirënë e zjarrtë.

Delegatët përpara drekës u mblodhën në mbledhje të mbyllur dhe zunë të kuvendojnë për zgjedhjen e komisionit.

Sikundrë q'ishte shkruar dhe në program, delegatët të tërë do të zgjidhnin një komision në mes tyre, i cili do të kuvëndonte për të dhënë një funt çështjes së abecesë.

Pas shumë kuvendë, u vendos që të zgjithet një komision fuqi-plotë prej njëmbëdhetë vetash; u vendos dhe që ky komision të zgjidhet me zë të fshehtë; vendimet (kararët) e komisionit do të marrin funt me shumë të zëravet, dhe delegatët të tërë janë të betuar që të bëjnë kabull ç'të vendosnjë komisioni.

Pas dreke nisi zgjedhja e komisionit.

Çdo klubi, shoqënije dhe qyteti j'u dhanë dy zëra; pra ata delegatë që kishin' ardhur me një shok, kishin secilido nga një zë; ata që kishin' ardhurë vetëm nga dy zë dhe ata q'ishinë të dërguarë prej dy shoqërive kishin' nga katrë zë.

Çdo delegati j'u dhan' aqë bileta sa zëra *kishte, dhe u vendos që ay që të fitojë më tepër zë, do të jetë kryetar i komisionit.*

Na fryt i zgjedhjesë:
Bajram Topulli
Buda Dimitraq
Cilka Ligor
Fishta Gjergj
Midhat Frashëri
Mjeda Andrea
Nyzhet Vrioni
Peci Sotir
Qiriaz Gjergji
Shahin Kolonja

Me qenë se Zoti Fishta nga 52 zërë fitoj 49, u zgjodh për kryetar. U vendos që komisioni të mblidhet të nesërmen në mëngjes...

Atë Fishta, pastaj me ate fuqi së fjalës q'e ka vetiu, tha se sado q'ësht' i dërguar prej shoqërisë "Bashkim", s'ka ardhurë për të mprojtur atë abece, po për të gjeturë një mënyrë që të bashkohemi të tërë...

Për tre ditët e ardhshme, thuhet *komisioni këto ditë punoj në mbledhje të mbyllurë*. Pikërisht këto ditë nxitën diskutimin se kush e hartoi alfabetin, duke krijuar edhe debatin mes Gjon Ujkës dhe Atë Pashko Bardhit që ndërtoi këtë shkrim. Duhet thënë se në asnjë moment, pyetjes së shtruar që në titull nuk synojmë t'i japim një përgjigje shterruese, por të parashtrojmë një çështje e cila vijon të mbetet e pazgjidhur përfundimisht, duke treguar të dy anët e saj.

Më poshtë është vendimi përfundimtar i *komisionit* i cili vendosi të përdoreshin dy alfabete nga të cilët mbijetoi i dyti, ai që akoma dhe sot përdoret për të shkruar gjuhën shqipe.


Monastir, 7-20 Vjeshte e teatr. 1908.

Vendimi i Komisionit mbi çeshtjen e Abecese.

Pas qe u-kenduan verbalisht e dikur t'jera e pas qe pa-mit ce puna qe kishim kur atë mjoft e made, po fo nga ca te na kenaqte te folure e t'i barbente si fjerpërimit te fakes si te perhapunit te diturise ndër ne; te dijsi edhe nga disa edhe te pajisëme u-kujdsem prapa e me pëlqimin te te folure u-vendos qe te mirret Abeja e Stambojit e me te bëkk edhe qe Abece-jët latine qe te mesohen e te perdoren bashkarisht ne mest te Bqypetve vet. Mesimi nde shkja do te jete i detyruem e i de-tyrëshëm, se te dyja. Abetë janë këto:

1) a, b, c, ç, d, ð, Dz, Dž, f, g, gj, h, i, j, k, l, ll, m, n, nj, o, Pp, q, r, rr, s, sh, t, th, u, v, x, y, z, ç, ž.

2) a, b, c, ç, d, dh, Ec, Ëc, f, g, gj, h, i, j, k, l, ll, m, n, nj, o, Pp, q, r, rr, s, sh, t, th, u, v, x, y, z, zh, zh.

U-dëftua edhe diturisë e Komisionit e pëlqeu dëme, qe pas dy vjetve te mbahet qe kongres t'jatë, dhe e thure t'a vendosë. Kongresi i sotëm fun vënë e letërtuar te fakes Bqypes.

Sotir P. Peci S. Qiriaz Gjergji Midhat Frashëri
Fofë Shëna A. Budua N. Frrok Bajo Topulli Atë Cilka.

Vendimin e Komisionit e pëlqyen te fëk zz. delegatë, te cilët po e nenëshkruajne dyke dëne besen se kane per t'e mbajtur.

D. N. Mela Gjon Pojani Stefë S. Luteriqi
Shaban Ali Gramenos Rok Boridi Mbagnesa
Sulejman Ch. Ibrahim Kemal Ali Efendi Selim Efendi
Fejzi Toma A. Zerdeli
Sabri Hykmet Efendi

Genim. — Ne kete *fac-simil* mungojne disa nenëshkrime.

Pasi u prezantuan alfabetet nga Luigj Gurakuqi, Atë Fishta mori fjalën dhe, sikurse tregon raporti, *çkoqiti abecenë* dhe *tha se abece e Stambollit ësht' e mjaftë për nevojat e kombit, po, me qenë se shumë herë për të shtypur libra larg Shqipërisë dhe për të hequr telegraf kemi nevojë për një abece latine, komisioni u shtrëngua të marrë dy abece...*

Pas fjalës së tij, *gjindja rrëfeu gazë duke përpjekurë duartë dhe duke thirurë: Roft abeceja!*

Nëse shkrimtarët shqiptarë do të ishin një komb, kjo ditë mund të ishte festa e tyre kombëtare. Gjuha shqipe, si atdheu i tyre i përhershëm, ia del të kapërcejë çdo kufi politik e shoqëror, duke i marrë të gjithë në truallin e vet, majë të cilit është ndërtuar tempulli me faqet e secilit libër që javën e kaluar u ofrua nëpërmjet *Panairit online*. Prandaj alfabeti është në secilin skaj të tempullit të letërsisë shqipe, vende – vende prej xhami nga ku përgjatë shekujve futej brenda e vetmja dritë lirije.

Anëtarët e shoqërisë "Bashkimi"

(« Mallkimi i priftëreshave të Ilirisë » të Mira Meksit)

PIRATERIA NË QENDËR TË DISPOZITIVIT NARRATIV

Alketa Spahiu
Doktor në letërsi i Universitetit të Sorbonës
Profesoreshë letërsie në Paris

Alketa Spahiu

Antikiteti shtronte në mënyrë të pareshtur pyetje mbi origjinat e botës, mbi burimet e vetë antikitetit. Këto çështje projektoheshin mbi të shkuarën, me qëllim shpjegimin e së tashmes, që vihet prapë në pyetje sajë ngjarjeve natyrore a të çuditshme e të pashpjegueshme. Gjithë një mitologji ka pasuar si rrjedhim i këtyre përsiatjeve, çka ka ushqyer mandej si historinë dhe letërsinë, këto dy trungje të pandara. Mbi to mbështeten njohjet tona dhe shuma e pikëvështrimeve mbi të shkuarën.

Por bota jonë sot vështrimin e ka nga e ardhmja. Nën kumtin e para-ardhësve, ne hamendim mbi të ardhmen si diçka të errët dhe po aq të frikshme. Atëherë bota sot frymon sërish duke përdorur dispozitivin antik, për ta zbutur atë drojë e pasiguri. I hapet kështu vendi një demiurgu, por drejt një bote të shqyrtuar nga prizma transhumaniste, domethënë: e ardhmja e afërt ndoshta me kolonizimin e planeteve rreth nesh, por shqyrtime që si shqetësim kryesor kanë njerëzoren. Njëlloj si zotat antikë, që pluskonin mbi dashurinë, betejat, shkatërrimet e transformimet, pushtetin, transmetimin e me radhë.

Me këtë frymëzim na duket se Mira Meksi observon të shkuarën në këtë roman të ri. Sajë një pune impenjuese, kërkimi i saj duket se nis me zhvarrimin e së shkuarës, për të kërkuar në të përgjigje mbi thelbin e jetës, ose më saktë, mbi mëndeshat e saj: dashuria dhe vdekja. Të dyja janë pështjellueset e heroinës së romanit, që iu vendosen lexuesit përballë përtej gjinisë dhe moshës, sepse heroina është e mbathur me përmasë universale dhe historike.

Historia e saj është e njohur, por jo shumë e diskutuar. Teuta, mbretëresha e Ilirisë, grua e mbretit Agron, jetoi në fund të shekullit III p.e.s. Historianët përmendin disi periudhën e mbretërimit të saj, veç dy tri vjet nga jeta e kësaj gruaje që mbolli terrorin në ujrat që lagnin Ilirinë. E lindur për t'i përkitur legjendës, ajo arrin bëhet mishërim i saj. Ekzistenca e kësaj mbretëreshe lidhet me shërbimin në favor të Ilirisë. Luftëra ku mbretëronin zhvatja, më saktë pirateria dhe ajo çka do ta quanim, në terma modernë, "mosbindja civile" ose shpirti kryengritës.

Sepse Teuta mbretëron në këtë hapësirë luftarake si oponencë e fortë ndaj Romës. Historianët zyrtarë kursehen doemos ndaj figurës së saj; por janë historianët e artit dramatik që na orientojnë më shumë. Ata e radhisin Teutën përkrah të tjera perandoreve madhore bizantine: Irenës, Theodorës dhe Eudoksisë ...

Duke qëmtuar origjinat e "Natës së dymbëdhjetë" të Shekspirit (që ngjarjen e vendos pikërisht në Iliri), të shumtë janë kërkuesit që kthehen te figura e Teutës, si mbretëresha "që përballi ashpër pushtetin e Romës" (Ludovick Lloyd), apo si "gruaja që diti të mbretërojë pa ndihmën e burrave" (Thomas Hayëood në librin *Gynaikeion*) etj. Kjo pjesë e Shekspirit, ku vërehet mjaft përdorimi i termave të tregtisë dhe piraterisë, ia ka atribuar tipare të Teutës, personazhes së tij, Olivia, e cila ka mbetur shtyllë e shtëpisë, në mungesë të atit dhe vëllait.

Mbretërimi i Teutës merr fund pra, pas nënshkrimit të traktatit me Romën, pas të cilit u asgjesuan aktet e piraterisë. Shpjegim shtesë mbeten përcaktimet e Ciceronit. Ai i deklaronte piratët e antikitetit si "armiq të përbashkët të komunitetit" (communis hostis omnium) sepse ata i dilnin duarsh ushtrimit të së drejtës së përbashkët. Por ajo që sulmohet është dukshëm shpirti i aventurës, shqendërzimi i pushtetit të Romës, prirja për ndjesi të forta, ku Tjetri mund të bëhet edhe viktimë.

Teuta bart pra një emër që e identifikon, e veçon, e bën unike; pirate mbretëreshë, e cila jeton dhe hepon në piraterinë e zemrës, e ndjenjave. Kështu romani i M. Meksit arrin rangun e një krono-gjeneze të piraterisë, të legjendës që ka për aureolë ky akt. Pikërisht pirateria na duket aksi i narracionit në roman. Vetë rrëfimi përparon e rrugës rinovohet, sipas endjeve që raporton. Pirateria bëhet kështu shkas, në ecuri e sipër, për ta "piratuar" të shkuarën që ndjell parazitë te e tashmja, në favor të rrëfimit dramatik. Ishte pak a shumë strategjia e "përthyerjes" së faktit historik nga të gjithë dramaturgët elizabetanë, ku Shekspiri bënte pjesë.

Na duket me interes të evokojmë një analizë semantike të termit "pirat". Rrënja e kësaj fjale vjen si nga greqishtja πειρατής (peiratês), që vet rrjedh nga folja πειράω (peiraô) që shenjon aktin e « orvatjes», « provon shansin", "lëshimin në një aventurë". Por dhe nga latinishtja *pirata* : "kërkuesi i fatit", "iniciativë e orvatje", etj.

Me këtë optikë, bëhet e qartë se kjo figurë, mbretëreshë regjente, i jep vetes atributet e fisnikes, lëviz jashtë sferës së manipuluar nga burrat. Rangu i saj i hyjnisë bëhet i qartë nga aplikimi e përdorimi i balsameve detare me përbërje "algash magjike" të gjarpërit mitik. Ai që i fryn frymën, por që e lidh pas vetes përgjithnjë, edhe nën trysninë e dhimbjes së femrës e të mallkimit hyjnor, derisa ai identifikohet krejt me të, bëhet dubli i saj. Sikundër lexojmë: « Mbretëresha ishte shuar për Ilirinë».

Makllkimi që merr Teuta e ndryn atë. Nën ndryrjen e gjarpërit ("e vluara e gjarprit"), asaj i mbetet t'i bindet mbrojtësit të vet, gjarpërit, i cili e mban në jetë që ajo të ushqeje sërish legjendën, legjendën e vet. Njësh me gjarpërin, kjo mbretëreshë është vektori i narracionit, pre-tekst për legjendën e gjarpërit. Citojmë: « gjarpëri shndërrohej në vajze e vajza në gjarpër […] sa shkriheshin e bëheshin një, dhe s'kishte më dallim mes tyre ». Sikur historia e Teutës të ishte ajo e gjarpërit, por e stisur nga ai vetë.

Klima emocionale e romanit hapet njëlloj si në rastet e dashurive pasionante e të kobshme. Histori që jo vetëm tjerrin fatin e viktimave në labirintin e dashurisë, por sidomos luftën e tyre shpallur ndaj botës, thua se kjo botë mbetet në thelb e huaj për pasionet madhore e që bota nuk iu bëhet dot garant.

Prej këtej fusha semantike e dashurisë dhe erosit shkon paralel me atë të luftës e dhunës. Vetë akti i dashurisë bëhet betejë e mbretëreshës për ta fituar, por tashmë si femër, jo më si mbretëreshë. Gruaja brenda saj hidhet në luftën përkundër Demeter Farosit, nën petkun e erosit, si për t'i shpëtuar burgimit nga gjarpëri. « Kishte nisur me puthje dhe kapërthime të egra që u kishin lëne vraja pasioni në trup ».

Me stampën e boshit në mish, Teuta e shpraz substancën e vet. Këtë orvatet të mbushë gjarpëri, herë me fjalë të hallakatura nëpër kujtesë, herë me materjen fantomatike, për ta vulosur "martesën" e tyre: « gjarpri i detit vazhdoi t'ia pastronte plagën me gjuhën e tij të mprehte dhe t'i sillte alga magjike deti që ia vendoste mbi të ». Kështu Teuta endet mes këtij boshi që mishëron e nuk e mbush dot, dhe fallusit, si premtim shpresë i dashurisë.

Me gjithë prirjen drejt pathosit (sepse personazhi Teutë duket ka nevojë t'i japin dashuri, si e vërtetojnë shpërthimet e saj : « pjesën më të madhe të kohës do dashuroj Demeter Farosin ») aspekti sentimental fshihet para shfaqjes së simbolit fallik, që penetron mjaft në roman; këtë e vërejmë qysh me paraqitjen e mitit të Ilirisë që bazohet te gjarpëri. Duket se ai shfaqet si garant i Teutës, mishërim i frymës së vendit ku ajo mbretëron, totem që si zgjatim ka shpatën, atribut tjetër i tij : « kur të më hajë dora për shpatë » apo dhe « me sikën në dorë ».

Kujtimi i gjarpërit e bën edhe më të dendur e më joshës, më të errët e goditës misterin e legjendës së Teutës. *Gjarpëri rrëfen*, ai zbërthen historinë, ngjarjen e Teutës e të origjinave kaotike të mitit të saj që përzihet me atë të Ilirisë, ku secili endet si pirat për pjesën e vet. Kjo histori duket vihet në rakordim me ndërtimin e imazhit të heroinës, duke ndjekur veç ligjet e rrëfimit oral. Rrëfim ky që, i detyruar nga harresa, i jep risi mandej ligjërimit, sepse rreziku i harresës sjell përdorimin e kujtesës duke i dhënë frymë tjetër jete.

Gjuha ligjërimore e reptilit është një ligjërim ku struktura kockore s'duket. Si përkatës i gjuhës së gjarpërit, ky ligjërim identifikohet mandej me gjarpërin, duke ia marrë atij hua aspektin origjinor të gjuhës, atë të gjuhës epike, që zapton gjithë hapësirën e rrëfimit. Gjuhë pra e origjinës, e asaj që oraliteti e bën të variueshme, lëkurëndërruese e të shumfishtë në delirin e gjarpërit-aed që pjell miti: « leskerat e gjarpërit të larzuar në trupin e faltares u kreshpëruan rrëmbimthi ».

M. Meksi e përdor këtë mit të gjarpërit si matricë të narracionit në roman. Është një mit që bart në vete një tjetër mit, e që i jep fuqi risi, nën vështrimin e lexuesit të mbërthyer në vëmendje. Rrëfimi ndjek parametrat e funksionimit të mitit e të legjendës; në këtë përzhitje del një metaforë e shkrimit, për sa kohë ushtrohet kujtesë, ndërsa është kujtesë. Kështu lexojmë se : « C'thotë tjetër gojëdhana » - fillon prapë rrëfimi , si për ta drejtuar diku e mandej për ta pasuar, thua nën "hyqmin" e këtij rrëfimi - « në atë kllapi të stërgjatur kish patur mjaftueshëm kohë të lebetitej e tmerruar prej tij gjer në asht ».

Vula e kulturës së rrëfimit gojor, e "gojëshkrimit", është e dukshme në mënyrën e rrëfimit të këtij romani. Jo vetëm në strukturën narrative, por dhe në frushullimën e re që kjo retorikë i sjell rrëfimit shqip. Na duket njëfarë zbutjeje të tij që arrin M. Meksi, pas betejash sinjifikante letrare që është përkthimi prej saj i autorëve botërorë. E vërejmë këtë edhe në dimensionet tragjike të personazhit Teuta, vetë drejtohet nga një forcë e brendëshme, karakteristikë kjo e heronjve mitologjikë, me peshën e fatit mbi krye. Këtu fati mbetet malli që "piraton" gjarpëri i kujtesës së gjatë.

Fati i Teutës është efektivisht i lidhur me piraterinë. Me piraterinë si pjesë e dramës së dashurisë në sfondin e vdekjes; kjo paraqitet si busull e personazhit, përderisa mania për pushtim duket veç tentativa për të dalë nga historia e gjarpërit. Vetë pirate, Teuta i rrëmben piratisht kujtesën gjarpërit. Nga përtej varrit ajo ushqen e mban gjallë legjendën që uzurpon, pushtim ky që respekton e garanton prapë ligjet e rrëfimit gojor të eposit.

Na vjen ndërmend ai film i habitshëm japonez, "Heshtja nuk ka krahë", ku pothuajse e gjithë ngjarja na jepet nga pikëpamja e krimbit të mëndafshit. Dhe gjithë filmi na paraqet mandej një lloj deliri sa jashtë-kohor, aq dhe mitik. Në romanin e M. Meksit ne hasim në një gjarpër aed, në delir. Delir, në kuptimin poetiko-filozofik, ku ai shket duke na ridhënë *si botë* atë që e kemi por normalisht para syve. Me të cilat lexuesi ndjek vetë këtë delirim të gjarpërit rrëfimtar, tani më shumë si pjesë e letërsisë që hedh vështrimin nëpër epope.

TRE LIBRAT FITUES NË PANAIRIN E 23-TË TË LIBRIT



Vlora Nikçi, *Kangë popullore erotike*

NGASJA EROTIKE NË POEZINË POPULLORE

Shaban Sinani

Në botimet që mbledhësit e folklorit, individë e institucione, i kanë bërë lirikës popullore, *eros*-i nuk ekziston. Përmes një termi tinëzar, *lirikë dashurie, këngët mirëfilli erotike janë lënë jashtë. Mund të* kenë qenë arsye të ndryshme. Në Tiranë këto janë konsideruar si *të shthurura, licensioze,* me ndikim të keq në edukimin e rinisë. Në Prishtinë ndoshta ka ndikuar më shumë kujdesi për *namuzin gjuhësor,* një lloj *puritanizmi i brendshëm.*

Libri i Vlora Nikçit *Kangë popullore erotike* ka tejkaluar kufirin e këtij përjashtimi, cilado qoftë arsyeja. Janë pak këngë, *kangë të vjetra,* që ajo i ka dëgjuar si shumë të tjerë, por, ndryshe prej të tjerëve, duke përfshirë edhe folkloristët vetë, pati lirinë e brendshme t'i rendiste e t'i botonte.

Me këtë libër Vlora Nikçi u ka hapur punë studiuesve të traditave gojore, të cilët do të jenë të detyruar të ripërkufizojnë termat *lirikë dashurie* dhe *lirikë erotike.* Të afërt mes tyre, këto dy terma as e përfshijnë, as e mbulojnë njëri- tjetrin. Këtu nuk është fjala për *fjalët e ndaluara* të botimeve të mëparshme të lirikës shqiptare, të cilat në *lirikën e dashurisë* zëvendësohen nga një figurë poetike *(molla, dardha, ftoi)*, kurse në *lirikën erotike* thuhen pastër, si çdo fjalë tjetër e gjuhës shqipe, si në këtë dialog të djalit dhe çikës n'zjarrmi të erosit:

-T'hangsha cicat për ndarsjetull!
-Kqyr ma poshtë, se e gjê 'itjetër.

Është diçka më tepër, që sjell libri i Vlora Nikçit *Kangë popullore erotike.* Para së gjithash janë *këngët që kanë funksion inkurajues, funksion nxitës të dashurisë fizike,* të erosit siç e përcillte hyjnia greke *Eros*, funksion që nuk e ka asnjë cikël tjetër këngësh popullore. Këto këngë i kemi dëgjuar të gjithë kur vinte momenti i tyre në ceremonialin e dasmës tradicionale, *kur hyn dhandri n'kuer*, dhe jo djemtë moshatarë, por motrat, inkurajojnë vëllain e tyre të mos druhet dhe *të mos e zgjasë*, ta zhveshë nusen e re dhe *të marrë e japë kënaqësinë emezipritur:*

Dhandri jonë asht qen,
Kape mos u tremb
Se je vllau jem
Dhandri jonë asht ujk,
Kape mos u tut!

Këngë *me karakter të mirëfilltë celebrues, urdhërues,* për t'u hequr drojën dy të bashkuarve në një familje të re, siç ishin dhe *kangët e kënāsë, kanagjeqit.*

Një pjesë e këngëve që ka mbledhur Vlora Nikçi shenjojnë *inicimin*, *rishtarinë*, krenarinë e djalit dhe çikës që *dolën nga fëmijëria* dhe tani *i kanë të gjitha*, para së gjithash fizikisht, për t'u sjellë si të rritur:

Dy të mira në mahallë,
Njana shoqes po i çon fjalë:
Cilla e kem cicën mât'bardhë?
Ûn dukat, tiqelibar,
Ûn jaranin ta kam marrë.

Ose:

Matmi vithet, t'gjânaikam,
Ndaç me kut e n'daç mepllamë!

Mburrja me *rishtarinë*, me *jam bâ për burrë*, mandej edhe më fort, *un jaranin ta kam marrë*, nuk ka të bëjë me *dashurinë që sublimohet* në lirikën popullore, por me kënaqësinë fizike që vjen prejdashurisë.

Vlora Nikçi më së parit i ka shkulë kufijt pengues prej mendjes së vet dhe, e bindur se *kënga e popullit nuk redaktohet* as bëhet më e fisme se ç'është, ka bashkuar në librin e vet edhe lirika të vjetra që nuk i binden jo qëllimeve edukative, por as *shukrëmendeve*, po të përdornim një formë të hershme të *Mesharit* të Buzukut për *sakramentet.* Janë këngët që lëvdojnë jo besnikërinë ideale, por të kundërtën, adulterin, tradhtinë:

Haram burrit, gja s'po i lâ,
Âsht i keq e s'duhetgjâ,
Âsht i keq, kurrgjâ nuk duhet,
Seni i mirë për tâ nuk ruhet!

Dhe na sjell, dora-dorës, deri në një pikë ku *lirika e dashurisë* dhe *lirika erotike* jo vetëm s'puthen e s'përputhen kund, por dalin ballë për ballë njëra-tjetrës, me kumte krejtrivalizuese:

Nuse e çikë janë nisë në krua,
Tasin n'dorë, burìn' ngarkua,
Djali prapa ju paska vnua:
Dal, bre çikë me folë me mua,
N'mujsh qat nuse me mamsitnua;
Djal' i dadës, mos ki dert,
Mos të dalt nusja, do dalvetë.
Si n'dish, çikë, çka asht njerzia,
Bahi bashkë, dilni të dyja.
Nusja e çika me t'shti dërmjet
S'të lshojnë ethet dymdhetëvjet,
Nuk t'merr gjumi as për tremdhetë!

S'ka kurrfarë *shkandulli* në këtë këngë, siç s'ka *shkandull* në *epin e Zukut Bajraktar*, kreshnikut fatkeq që *e ëma e le lidhun rob, për dashni t'vet me armikun.*

Në lirikën e dashurisë gjithçka është rrezëllitëse, djali dhe vajza janë shenjat e bukurisë fizike dhe shpirtërore, modele të denjësisë së përjetshme, *lindun për njani-tjetrin.* Nderi i gruas në këtë pjesë të lirikës është si në *Kanun.* Kurse në lirikën erotike djali nuk turpërohet aspak pse çikën *ja kanë shti në dorë*, por *ka qender* thjesht se *ma ka mbytë krejt*:

Po ban djali: unë i mjeri,
Ma ka rrokë dadën ni njèri;
Pse ma rroku, s'pata dert,
Po ma rrzoj, ma myti krejt,
Kur u çua, ecke ma lehtë!

Kryehyji i grekëve të vjetër, Zeusi, ndërronte formë trupore që nga *shiu i artë* deri tek gjallesat më pak poetike të botës për të arritur qëllimet e tij trupore. Të gjitha trashëgimitë e mëdha të popujve janë të mbushura me dashuri dhe tradhti tronditëse, me mençuri dhe marrì mitologjike. Legjendat dhe eposi shqiptar gjithashtu është i mbushur me pasione të mbara e të mbrapshta, duke përfshirë edhe incestin e ndaluar në prag. Lënia jashtë e lirikës erotike i ka ka kthyer djemtë dhe vajzat e dashuruara gati-gati në *ashkëtinj*, asketë; që e duan njëri-tjetrit

(Vijon në fq. 9)

"Enciklopedia e mërgimit" me autorë Entela Tabaku, Shqiptar Oseku

ENCIKLOPEDIA E MËRGIMIT – TË JETOSH ME NJË "PËRBRI" BRENDA TEJE

nga Ballsor Hoxha

Përmbledhja me poezi "Enciklopedia e mërgimit" është poezi si gjendje, si asnjanësi, si jetë prapa çarjes së saj në dy pjesë. Ku nuk arrin të kalosh kurrë matanë, as në vendin mikpritës e as në vendin e lindjes. Apo ku sa herë kalon matanë, prapa në vendlindje apo prapa në mërgim, ke lënë prapa gjysmën tënde të jetës. Dhe pikërisht kjo të neutralizon dhe të mbanë në një gjendje të përhershme reminishence. Në të vërtetë ke vetëm një shpëtim: ta duash arritjen, azilin, mërgimin, duke e lënë të tërën në duart e fëmijëve, dhe pastaj të klithësh " pse me të fillojnë fëmijët e mi" (poezia nën "country of destination"). E "fëmijët fillojnë" vetëm se ishin të pamundur matanë! Në vendlindje!

Apo, kjo gjendje, kjo asnjanësi, ky neutralizim krijohet sepse je gjithmonë me një "përbri" përbrenda, ka një përbri, ka një rrjedhë tjetër, cilado që është përpjekja jote

/sa herë kam shëtitur kështu/ buzë këtij lumi/ kam pritë me iu shkri akujt...

/dhe rrjedh/ rrjedh gjithmonë/ një lum tjetër/ përbri (poezia nën "acculturation")

Më tutje po e shpalosim atë që fatthotë "Enciklopedia e mërgimit", nëpërmes disa prej fjalëve të saj më të dhembshme:

Azili,

/pse askush nuk do ta mbarojë byrekun e nënës/

.../(a është ky azili babi)/ (poezia nën "asylum").

Pse askush nuk do ta mbarojë byrekun në poezinë nën "asylum" derisa e kanë marrë rrugës për në mërgim? Derisa ai është prishur dhe kundërmon, nën intervistat e shumta të vendit ku kanë ikur familja? Apo ndoshta kjo do të thotë ta mbarosh – *kopshtin e gjyshes, shiun e verës mbi strehë, aromën e ftonjve* – ta mbarosh thyerjen e jetës, ta gëlltisësh të ndarë dhe të lënë prapa.

Apo pikërisht kjo të bën ikanak, i ikur, ikës.

Apo, që është më e dhembshmja "mbaron byreku" përgjithmonë!

Sipas etimologjisë Asylum, buron nga shprehja për statusin e njeriut pa të drejt prone, që kaloi deri tek sinonimi për – strehë -, strehimore, etj. Azil ishte edhe burgimi, e edhe burgimi i të sëmurëve mendor.

Prej këtu azil ka mbetur një simbolikë e të qenit i ikur, në ikje, por a ndalet kjo ndonjëherë. Apo ndalet në 'izolim'. "Një herë mërgimtar, tërë jetën mërgimtar" thonë poetët në këtë përmbledhje me poezi mbi azilin. Një herë i dalë prej vendit, vendlindjes, atdheut, mëmëdheut, a e gjen një tjetër ndonjëherë?

Mërgimi,

fjala Mërgim, në gjuhën tonë është edhe emër personi, për të kujtuar familjarët e mërguar, apo edhe fenomenin e të qenit të mërguar dhunshëm, ndarjen e familjes etj.

Në të vërtetë Mërgimi është ndarje, ikje dhe ndarje, dhe kalim i të njohurës në të panjohur, ku çdo gjë e jotja, prej gjuhës e deri tek ëndrrat janë të huaja, dhe të dallueshme nga të tjerët.

Kjo ndarje është jo vetëm ikje, por edhe lënie, e një jete të plotë, një jete të tërë, një përhershmërie të pandalshme.

Kjo ndarje është çarje, në dy jetë, jetën e natës - ëndërrimit ku je shqiptar, dhe jetën e ditës ku je nëpunës i një "atdheu", një strehe të panjohur. Siç thuhet në "fatthënie" të përmbledhjes mbi Mërgimin.

"*Burra Gra Fëmijë shtrëngojnë ujin* " (poezia nën "migration"

Por është e njëjta gjë, është fenomen kur Burra Gra e Fëmijë shtrëngojnë ujin, për t'u kapur, për t'u mbajtur, për të jetuar tutje. Por prej ku? Dhe ku?

Ndoshta kapur për uji, gjen!, edhe atdheun e ri, mëmëdheun e ri, dhe edhe strehën, azilin e ri. Në ujë! Në fundin e tokës, dhe fundin e gravitetit, fundin e rrënjëve, dhe për këtë fundin e të ardhmes.

Zvogëlimi,

pak më tutje jeta në Azil, Mërgim, është jetë e cila nuk të njeh "mbahem për vedi e për çfarë kam në duer/... gjithmonë e huej/", është jeta, si jeta e poezisë nën "alien". Ndoshta është gjendje në zvogëlim, në përhumbje, në të mbetur të pandalshëm/në mbetje të përhershme.

"Unë nuk e di si e ballafaqon ti vogëlsinë tënde të paskajshme", i thotë kolegu kolegut pikërisht në poezinë nën "border" (Kufi), e kufiri vetë kuptesa "se e kemi vetëm njëri tjetrin: se askush prej nesh s'do të kthehet më kurrë në shtëpi".

Ky zvogëlim, kjo përhumbje, të mbetur të pandalshëm vjen si mungesë. Mungesa është "si diell i fortë që vret", në poezinë nën "certificate of identity". Metaforë mjeshtërore ku mungesa është dielli, vetë e paikshmja dhe jeta, e jeta mungesë.

Pikërisht sikur në romanin Identity të Milan Kunderës, ajo, e mërguara ka identitetin e vet në tjetrin, është vet tjetri, i dashuri, por jo në jetë, jo në realitet, por me emrin tjetërsues – Lars. Në një azil pleqësh. Në një dementia/Alzheimer të pleqërisë. Në të vërtetë , gjithnjë në ngjashmëri me Identity të Kunderës është në një ankth ëndrre, parathënëse apo parandjenje.

I huaji,

Ky është stacioni i fundit ku përfundon azilanti, i mërguari. Është fundi i identitetit siç e dimë, dhe është fund i cili të gjen sikur në poezinë nën "foreigner"

"e gjeta më në fund stacionin/ me shumë vonesë/ treni më iku përpara këmbëve/ u ula në stol me pritë tjetrin/ më mori gjumi nga lodhja/ më zgjoi zani i një fëmije/ "babë, babë", ku je?/". ("foreigner" sipas përshkrimit në anglisht në "Enciklopedia e mërgimit" (e që është fjalëzim i Enciklopedisë ndërkombëtare mbi Migrimin përpiluar nga Organizata Botërore për Migrim) është: "Një person që i takon... një shteti tjetër."

Pra në një shtet tjetër, një person i cili ka mbetur në stacion, mund të zgjohet vetëm duke përkitur dikund! E ai përket në fjalën, në emrin e tij: baba.

Expatriate/ i çatdhesuar,

dhe **brenda-lidhja**

brenda-lidhja (Interteksti) në "Enciklopedia e

mërgimit" si zanafillë, fije lidhëse, si tjerrje e jetëve, të gjithave, para dhe pas thyerjes, ndarjes dhe Azilit, është tërësia e një jete të parë, të thyer para dhe prapa azilit, mërgimit dhe tëhuajsimit. Është mbijetesë, qoftë edhe unike shqiptare:

"... endet tash vetëm hija e besës sate/ ... një ditë do të kthehesh/ Konstantin" (poezia nën "expatriate")

Poetja e ka gjetur strehën, azilin e mërgimit të saj në hijen e besës së Konstantinit. Aq më shumë ajo e vulos kthimin e tij – një ditë -. Kështu, diku në ndërmjetësinë në mes ëndërrimit dhe realitetit, dëshirës dhe pamundësisë, ajo rikthen Konstantinin, zanafillën e mërgimit shqiptar, në vendlindje. Është brenda-lidhje aq e thellë psiqike që kërkon deri në kockën e të mërguarit të parë, deri në vdekje e tutje në besë, e në hijen e besës, deri në "kush i pari bani"!

Poezia e "Enciklopedia e mërgimit" është një tmerr i cili shprehet me tërë vetëbesimin e një azilanti, dhe në këtë është komedi e zezë në momente të saj. Poezia mbi mërgimin këtu del si asnjanësi, tëhuajsim, dhe pafundësia e mundësisë së tëhuajsimit si antidot, si në poezinë nën "culture": poeti "merr veten me të mirë" dhe shkon aty ku shkohet për të blerë "gjëra edhe më të huaja se vetja".

Brenda – lidhja në të vërtetë është fuqia dhe shpresa vet, që shpërfaqet dhe ndërhynë në meditimet mbi azilin, përmes tregimeve popullore mbi udhëtimin/ mërgimin, si në poezinë nën "biometrics"

/Ura Sirat që shpie në xhenet është më e hollë se floku/ më e mprehtë se shpata/ më pështpëriste im gjysh/... Ahmet, dëgjo nipin tënd: xheneti e xhehenemi/ janë këtu: në honet mes nesh/ në tokat e askujt/... dëgjo Ahmet, atje ku je: ura Sirat qenka ndryshe? Edhe kur kalon në anën tjetër/ plagët prapë të kullojnë gjak.

Pastaj brenda - lidhja në poezinë e "Enciklopedia e mërgimit" është e ngritur si strehë brenda azilit, përmes mënyrës së – dëshirores – së gjuhës shqipe. Në dëshiroren e shqipes, e cila shfaqet në dy poezi, si në poezinë nën "costummary law"

"*e mira ta gjettë rrugën, e të kaptë për qafe"*

apo në poezinë nën "bona fide" (Shq. Gjendje mendore që shprehë sinqeritet në besim dhe qëllim)

/u gëzofsh/ u trenofsh/ rënsh e mos u qofsh/ të daltë flaka/... / Dëshirorja, kjo kullë e shqipes në mërgim/

Poezia e "enciklopedia e mërgimit" është poezi e cila ka dy kohë: të ditës kur njeriu, azilanti është nëpunës, dhe kohën kur azilanti është shqiptar, në ëndrrat e saj/ tij. Dhe kjo është prezenca e tokës së lënë, atdheut dhe mëmëdheut, jetës së thyer, në prezencën e realitetit. Kështu azilanti duke bartur në realitetin e tij me vete një botë të tërë. E me këtë në jetën e tij duke u ndërlidhur interteksti i çdo gjëje, dhe çdo detaji, në çdo moment. Brenda – lidhja duke ndërhyrë nga jeta e kaluar, asaj të ndarë, në realitetin e prezencës, mbetur matanë, brenda dhe jashtë saj, në përhershmëri.

fatthënie

/ Dhe gjindja pyesin, çka je ti në të vërtetë. E njeriu u thotë: unë jam./

/Si totem i lashtë: Jahue: jam./

/Ky që jam./ (nga pjesa e hyrjes titulluar "fatthënie")

Ç' është kjo fjalë "Mërgimtarësh" – fatthënie? Ndoshta ata mbesin peng i fatit të thënë, fatit të ndryshuar, fatit të parë, fatit të dytë dhe panumër fatesh që radhiten në jetët e tyre, mbesin matanë dhe nuk arrijnë kurrë askund, mbesin në një gjendje. Dhe pikërisht kjo i fikson, i obsesionin me fatin.

Por, ndoshta në azil, në mërgim gjejmë atë që na e fshehin, kufijtë, atë që nuk e njohim kurrë jashtë kufijve tanë, se jemi, dhe aq, jemi. Apo se ne jemi "aty ku fillojnë fëmijët tanë".

Apo se ne jemi të pandryshueshëm në tërë thyerjet, ndarjet, etj. Se ne jemi shqiptar në Shqipëri, apo shqiptarë në Suedi , e Finlandë si furrtarë me një këmbë çalë. Apo se jemi shqiptarë në retrospektivë: prej vajzës së llastuar të prindërve, bëhemi shqiptar vetëm në vendin e mërguar (poezia nën "diasporas"), dhe ecim lakuriq, se vetëm i huaji, ecën lakuriq. Por në të vërtetë, kjo thuhet ndryshe në poezinë nën "nationality"

/Prej nga je, më pyesin/...përgjigjem/ jam shqiptar/ thjesht pse s'kam më forcë t'ia shpjegoj prapë dikujt/ dhembjen time/

Dhembja e të qenit shqiptar (apo edhe kosovar) është aq e madhe sa poeti shqipton fjalën si asteroid brenda territorit të gjuhës dhe kulturës së huaj, pa asnjë kokëçarje për të gjetur një mirësi shpjegimi se ç' është shqiptar. Pa asnjë kokëçarje se çka shkakton shqiptimi i kësaj fjale në azil.

Fundi,

përmbledhja me poezi "Enciklopedi e mërgimit" është e shkruar nga Entela Tabaku dhe Shqiptar Oseku, dy autorë, por asnjë nga poezitë nuk shfaq autorësinë e tyre, janë asnjanëse në këtë aspekt. Sikur poetët/ autorët nuk duan të japin një emër mbi nocionet e enciklopedisë së mërgimit, duke qenë se mërgimi, nuk ka emër, nuk ka kombësi, as përkatësi, se ai është një e huaj që është, Jehau, Jam, cullak. Se, në të vërtetë mërgimi është universal dhe i njëjtë për secilin që e provon dhe e jeton.

Paqja

Poezia nën "green border"

/mërgimi sonte është një plak që shëtit qenushin/ nëpër një park ndripuar nga drita të verdha/...

Është plakur në mërgim ky personazh, dhe beftë i vjen në mendje një grua, të cilën, si në aurë të përbashkët, e ndien edhe qeni i tij të cilin ka dalë për ta shëtitur. "Por këto degët e mështeknave gjithmonë më hutojnë" thotë plaku, thotë mërgimi i plakur. Thotë se paqja nuk është e fundme asnjëherë.

(Vijon nga fq. 7)

vetëm për bukurinë si të Tanushës. Botimi që i ka dhënë lexuesit Vlora Nikçi, me librin e saj, i ka kthyer trashëgimit gojor shqiptar pjesën tjetër, *pjesën e munguar*, *lirikën e marrëzisë prej ngasjes së papërmbajtur erotike.*

Lule, cicën, kuj pjarua?
Djalit t'ri, të pamartua,
Ç'i vjen natën, pa pritua,
Se i martumi, popriton,
Veç kur vje, ma fort ëm don!
Po i hap kraht e po m'shtrëngon,
Si fërliku ëm rrotullon,
Sikur ujku m'kap e m'lshon!

Të kërkosh moral nga këngët ku djali e dada mendojnë *si me u dhanë*, jo *si me u ruejt* është një aventurë, aventura për t'u kthyer mbrapsht e për ta rindërtuar folklorin sipas librave të besimit dhe të edukimit. Dhe kështu do të na mbetej, siç dhe kanë mbetur jashtë qarkullimit, këngë të tilla që bëjnë të njohur gjendje shpirtërore të papërsëritshme në cikle të tjera:

Çika çikës po i çon fjalë:
Cilla e kem' cicën mat'bardhë?
Hajt ta vesim na qat djalë,
Veç ka 'i cicë kem' me ja dhanë;
N'mos daç ti, ia ap këthough'temen,
S'mujmë ta lamë si peshkun n'zall,
S'mujmë me e lanë pa e gërkua,
Mos me ditë rrugën ka me shkua!

Herët a vonë ka për të dalë problemi i shkallës së pranisë së erosit edhe në letërsi, në letërsinë shqipe. Përveç Andon Z. Çajupit, Mitrush Kutelit, Migjenit, Pano Taçit e ndonjë tjetri të rrallë, shkrimtarët shqiptarë i kanë qendruar larg ngasjes erotike, me sa duket edhe në këtë rast për të pasur *një letërsi me nur*.

Kënga popullore erotike, edhe në këtë libër të Vlora Nikçit, është poezi e zbulimit fizik të trupit njerëzor, e lartësimit të çdo pjese të tij. Por kjo është një *lakuriqësi e bukur*. Askush nuk shqetësohet nga zbulimi trupor në shtatoret e lashtësisë antike greke dhe romake apo në pikturën e Renesancës europiane. Krejt tjetër është *lakuriqësia tregtare*, *lakuriqësia e pornografisë*. Nuk është lirika popullore e erosit ajo që ka nevojë për disiplinim.

24
ثقافة
كاتب من العالم
بسنيك مصطفى
المأساة الإنسانية واحدة
بأسماء مختلفة
بطاقة

(Intervistë e shkrimtarit Besnik Mustafaj botuar me 10 tetor në suplementin kulturor të gazetës së madhe arabofone Al Araby, që del në Londër dhe shperndahet në mbarë botën.)

BESNIK MUSTAFAJ: Dhimbja njerëzore është një dhe e vetme

Si do e përshkruanit peizazhin letrar dhe kulturor të vendit tuaj ?

Një kulturë që nxiton të dale nga një izolim i gjatë dhe i tmerrshëm, e shtyrë nga një dëshirë shumë e fortë për t'u hapur ndaj botës, pa i dhënë kohë vetes të reflektojë lidhur me çfarë është «hapja ». Për pasojë, kjo hapje në një masë të madhe po bëhet në mënyrë kaotike dhe shpesh në dëm të identitetit kombëtar.

Si e paraqisni veprën tuaj para lexuesve të rinj të huaj?

Lexuesve të rinj, që vijnë nga horizonte kulturore të ndryshme nga kultura ime, u them se vepra ime tregon sesi drama njerëzore, e shkaktuar nga një politikë çnjerëzore, është e njëjtë si për një popull të vogël edhe një të madh dhe përjetohet njësoj nga individi, pavarësisht gjuhës në të cilën shprehet viktima. Besoj se popujt kuptohen më mirë dhe më lehtë duke parë se kanë të përbashkët dhimbjen.

Me cilin nga librat tuaj do t'i këshillonit të fillonin ?

Ndoshta me « Një sagë e vogël », e cila në kronologjinë e romaneve të mi është i treti, që kam shkruar.

Çfarë çështjeje ju preokupon këto ditë ?

Izolimi për shkak të pandemisë zgjon te një popull që ka njohur diktaturën disa frikëra me rrënjë tek e kaluara, që një shoqëri, e cila ka jetuar gjithmonë në liri nuk mund t'i përfytyrojë. Te politikanët në pushtet, qoftë edhe të zgjedhur demokratikisht, një situatë e tillë zgjon dëshirën për t'u bërë sundimtarë, mundësisht diktatorë.

Çfarë ju tërheq në kulturën tuaj dhe çfarë do të donit të ndryshonit?

Sapo i kam dhënë botuesit tim në Tiranë një libër me tri novela, ku përpiqem të kuptoj permes imagjinatës nga vjen kjo prirje e shqiptarëve drejt dhunës autodestruktive. Pra, do të kisha dashur të ndryshoja pikërisht këtë dhunë në trashëgiminë tonë.

Po të kishit rastin ta rifillonit karrierën, çfarë rruge do të zgjidhnit?

Rrugën që kam bërë tashmë, pa i ndryshuar drejtim. Vetëm se do t'i jepja më pak vite politikës, për t'i lënë më shumë kohë shkrimit. Në moshën 62 vjeçare kam vetëm një ankth: A do të më mjaftojë jeta për të shkruar librat e ëndërruar?

Çfarë ndryshimi prisni apo dëshironi t'i ndodhë botës ?

Atë që thashë edhe për kulturën time kombëtare: Më pak prirje drejt dhunës në karakterin e qenies njerëzore.

Personazhi historik që do të dëshironit të takonit dhe pse ?

Armstrongun, i cili, duke hedhur hapin e pare në hënë, pati refleksin të thoshte atë fjalinë monumentale: një hap i vogël për mua, një hap i madh për njerëzimin.

Cili është sipas jush rreziku më i madh që kërcënon lirinë e shkrimtarit në botën e sotme?

Mendoj se kërcënimi më i madh për lirinë e shkrimtarit vazhdon të jetë ai, që ka qenë gjithmonë: pushteti politik në duar njerëzish, të cilët nuk e shohin veten si qeverisës por si sundimtarë.

Cila është kauza që mbroni? A mund të jetë shkrimi një kauzë në vetvete ?

Shkrimi është një punë thellësisht individuale dhe që bëhet në vetmi. Si i tillë, nuk mendoj se mund të jetë kauzë në vetvete. Vazhdoj të mbroj kauzën e lirisë. Liria politike ka shumë më tepër armiq të brendshëm nga ç'mendohet. Ky është zbulimi i trishtuar që kam bërë pasi erdhi liria për popullin tim.

Thuhet se «letërsia universale shkruhet nga përkthyesit». Deri në çfarë mase pajtoheni me këtë pohim dhe në ç'masë ju kanë shkruar juve përkthyesit?

- Përkthyesit i japin realitet këtij dimensioni universal të letërsisë. Por ata nuk do të mund të bënin asgjë sikur vepra letrare të mos e kishte brenda indit të vet këtë universalizëm. Nuk i lexoj kurrë përkthimet e veprave të mia. Pra, vërtet nuk e di deri në ç'masë përkthyesit më kanë shkruar. Italianët thonë « tradutore – traditore". Shpresoj gjithnje se ata nuk më kanë tradhtuar shumë. Gëzohem shumë kur nëpër shkrimet për librat e mi lavdërohet puna e përkthyesit.

Si do ta përshkruanit marrëdhënien që ju lidh me gjuhën, në të cilën shkruani?

Unë shkruaj vetëm shqip. Nuk mund të shkruaj me fjalët që njoh e që më kanë shërbyer, bie fjala, për të bërë dikur punën e diplomatit, por me ato që më nevojiten për të shprehur veten te teksti letrar. Vetëm gjuha amtare ma jep këtë liri shprehjeje.

Cili është autori, në kulturën tuaj, të cilin do të donit që bota ta zbulonte?

Mitrush Kuteli, një shkrimtar shumë i madh për ne shqiptarët, por që bota nuk e njeh ende.

Si do të donit të ishte imazh i juaj pas një mijë vjetësh?

Oh! Do të më pëlqente shumë sikur lexuesit e kësaj të ardhmeje kaq të largët ta gjenin sadopak veten te dhimbja dhe dashuria e personazheve të mia. Kjo do të thoshte se kam arritur t'i jap zë asaj çka është e përjetshme në shpirtin e shqiptarit si qenie njerëzore.

Një fjalë për lexuesin arab, që ju lexon sot.

Do të jetë kënaqësi e veçantë për mua t'i shoh veprat e mia në gjuhën e Shehrazades.

- Botohet në Rumani romani "Funerali i pafundmë" i shkrimtarit Visar Zhiti –

KORTEZH NËN PANDEMINË IDEOLOGJIKE

Kohë pandemia, madje e rikthimit të saj, të Covid-19, kështu duket, a s'kishte ende, por kjo nuk e ndalon dot daljen e librave, përkundrazi, edhe si kundërshti e gjendjes... Ndërsa romani „Funerali i pafundmë" i Visar Zhitit duket se është dhe një metaforë e fuqishme kundër pandemive ideologjike, çdo diktature, qe edhe ato duket sikur *rikthehen, nese nuk kanë ikur plotësisht. Me mesazhe të tilla është përcjellë dhe botimi i dytë në Rumani i këtij romani të çuditshëm, i pa ngjashëm me asnjë vepër tjetër, i cilësuar si* ***roman postkafkian****"...Sapo doli, tani nga Shtëpia Botuese „A", me përkthim* të përplotësuar të studiuesit dhe estetit Dr. Luan Topçiu. Pas suksesit të botimit të parë, me jehonë në median kulturore dhe televizive në Rumani, *që më pas ky roman do të botohej dhe në Itali) botimi i dytë në Rumani sërish, ka marrë dhe nga shqetësimet e tanishme, që na lanë diktaturat e perandorisë komuniste, që vçanërisht në Shqipëri, por dhe në Rumani i pësuan më rëndë.*

Botimi i ri është luksoz, i pajisur me një prezantim nga përkthyesi dhe një pasthënie nga shkrimtari rumun Liviu Lungu, që po i sjellim të përkthyera nga Dr. Luan Topçiu.

Ky është libri i katërt nga Visar Zhiti që botohet në Rumani.

MARRSHIMI I VERBËR I SHUMICËS
Nga Dr. Luan Topçiu

Romani „Funerali i pafundmë" është një udhëtim absurd i kortezhit terratisës pa një vendmbërritje, një sfidë e vazhdueshme e durimit sfilitës njerëzor në ballafaqimin me realitetin e brendshëm shpirtëror. Është një marshim funerali rraskapitës, një makth në të cilin mbartin dhe përjetojnë njerëzit, të drejtuar nga forca shtypëse, ndodhitë ilustrojnë absurditetin e situatës, herë me tone shpotitëse, herë deri në skaje karikaturale, herë me tragjizëm, por dhe me një lirizëm të pamunguar. Romani popullohet jo nga karaktere, por nga personazhet-maska, personazhet zëra ose thjesht personazhet hije të paforma që krijojnë kortezhin e pafund. Funerali është torturë e ngadaltë shumëvjeçare, gjë e shton dramacitetin, dhe jo rroposje e beftë. Ky kortezh i pandemive ideologjike shkon paralelisht me pandeminë COVID-19. Është marshimi i shumicës drejt një varri të nevojshëm, duke mbajtur një arkëmort enigmatik që nuk mbërrin në asnjë destinacion. Një javë më parë se sa të shuhet nga jeta, poeti i madh rumun Cezar Ivanescu lexoi dorëshkrimin e këtij romani, duke e përshkruar shkrimtarin Visar Zhiti si "***një shkrimtar origjinal me forcë të madhe dhe dramatizëm të rrallë***".

GRIJA E TMERRIT...
Nga Dr. Liviu Lungu,
Anëtar i Lidhjes se Shkrimtareve te Rumanisë

"Funerali i pafundmë" i Visar Zhiti, përbën një tekst me vlerë të madhe letrare. Përmes një gjetjeje krejt origjinale, arrin t'i induktoje lexuesit hidhërimin, grinë dhe tmerrin e një intelektuali në fundin e mijëvjeçarit të dytë, nga një qenie inteligjente dhe e kultivuar, me shpirt të hapur, tek e fundit, duke jetuar (mbijetuar) në kohën e diktaturës „të çdo lloji", diktatura me të gjitha shfaqjet e saj: me pamjen e opresionit, absurditetit, qesharakes, perspektivave të errëta, duke marshuar drejt qëllimeve me tregues të vagët, vdekje, ideale pa bazamente...Teksti, relativisht i shkurtër, duket që buron që diku përtej ballinës së parë dhe rrjedh nën pragun e faqes së fundit: kujtime, memento, metaforë me referime historike të qarta, historia e drejtuar dhe përmes metaforash, rrëfime me thekse tragji-komike dhe, vende-vende, cinike, grotesk, që dëshmon thellësi dhe frymë fine vëzhgimi, seri obsedante me ndodhi nga të cilat bien në sy disa, përsosmërisht të integruara, nga një lirikë e shkëlqyer...Për lexuesin e një hapësire gjeografike dhe historike të ngjashme me atë ku zhvillohet marshi i pafundëm funeral, romani shfaqet si një tekst që kuptohet më lehtë dhe asimilohet më shpejt. Por teksti dëshmon të njëjtat cilësi (si çdo letërsi e madhe) dhe lëçitje nga një lexues të tjetër të çfarëdolloji, ky fakt i detyrohet talentit letrar të pakapërcyeshëm të Visar Zhitit si dhe përvojave të tij si intelektual inteligjent dhe të kthjellët, pjesëmarrës në „kortezh"... „Funerali i pafundmë" është një roman që e kam lexuar me interes dhe kënaqësi dhe e them me zemër të hapur se në Rumani sigurisht që do të ketë jehonën e merituar. Dhe i lejoj vetes të besoj se botimi i këtij romani në Rumani do të jetë vetëm një hap për një popullarizim më të gjërë, që „Funerali i pafundmë" e meriton plotësisht!

(Vijon në fq. 13)

Mbi romanin "Pëllumbat i vrasin natën" të Virion Graçit

ALEGORIA E HISTORISË DHE REALITETIT

Sali Bashota



Hyrje

Virion Graçi është i njohur me romanet: "Të çmendurit në parajsë"(1995), "Shpata e ndryshkur" (1999),"Bijtë e zotit majmun"(1999), "Babai në shi"(2000), "Zonja pa emër" (2005), "Litari dhe lamtumira" (2011), "Stina e hijeve" (2014),"Djali memec" (2016), "Pëllumbat i vrasin natën" (2018), "Dead End"(2019) dhe "800 hapa larg Venerës" (2020).

Romanet e Graçit e projektojnë qartë idenë, tematikën, domethënien e narracionit, strukturën e tekstit, perspektivën e konceptit të tij shkrimor, për të shenjuar identitetin letrar të një zhanri që në shekullin XXI, është paprijës i shumë proceseve shkrimore në universin letrar të krijimtarisë së autorëve në përgjithësi. Në fakt, profili krijues i këtij shkrimtari me ide krejt origjinale në prozën e sotme shqipe, pa dyshim, e fuqizon më tutje konstatimin për vlerat letrare dhe estetike të letërsisë së tij.

Virion Graçi me romanet e tij ka arritur të sistemojë një vetëdije të re shkrimore në prozën e sotme shqipe. Për ta kuptuar thelbin e romaneve të Graçit, gjithsesi, është e rëndësishme të njihen shtresat shumëkuptimore të prozës së tij. Natyrisht, mund të dallohen veçoritë tematiko-motivore, struktura narrative, stili, gjuha, etj., të cilat e favorizojnë perceptimin e referencave të besueshme kritike se romanet e Virion Graçit, në përgjithësi e sajojnë aventurën e procedeut krijues, të ndodhur midis fahut realist, modernist dhe postmodernist. Shpjegimet e mëtutjeshme e dëshmojnë këtë fakticitet letrar, të realizuar në laboratorin e tij krijues.

Arketipi ëndrrës së pambaruar

Romani "Pëllumbat i vrasin natën" i Virion Graçit, ndërtohet përmes shtresave të veçanta kuptimore dhe narrative. Këto shtresa kuptimore e krijojnë paralojën e rrëfimit, duke u mbështetur në disa principe të së ndodhurës. Në planin e ideve, këto shtresa vetvetiu bëhen fiksion e metafiksion, bashkë me të papriturën, të pabesueshmen dhe të panjohuren, për të vazhduar më tutje, pikërisht me lojën simbolike të referencave apo gjetjeve ironike, duke funksionalizuar intertekstin si dëshmi për atë çka ka ndodhur apo sikur do të ndodhte tani apo më vonë. Mbase ky do të ishte në njëfarë forme vetë relacioni midis koshiencës dhe subkoshiencës, në praninë ose në mospraninë e atyre botëpërceptimeve që i përkasin fantazisë dhe realitetit, natyrisht me përfshirjen dokumentare të faktit historik.

Me romanin "Pëllumbat i vrasin natën" , Viron Graçi ka ndërtuar sistemin e shenjave narrative dhe figurative, përmes arketipit të një ëndrreje të pambaruar, të fokusuar në botën e realitetit për t'i kapërthurur fijet e dramës shpirtërore të personazhit, në një kohë dhe në një hapësirë të përcaktuar për rrëfim, mbase përmes trillimit apo shpjegimit të trillimit deri te përcaktimi i modelit mbizotërues si kujtim i së kaluarës, në të sotmen e sprovuar. Nga ky pikëshikim, filli i romanit paralajmëron komunikimin e dyfishtë, pra kodin e dyfishtë, që në fakt është veçori karakterizuese e postmodernizmit: "Neta ishte në ballkon duke dëgjuar pëllumbat". Unë, si zakonisht, isha duke fshirë këpucët ushtarake të tim eti, kur ra telefoni fiks. Nuk e ngrita telefonin t'i thosha..."

Përfytyrimi dhe shpërfytyrimi i realitetit ekzistues si paranojë, e fuqizon dimensionin e habisë dhe të dëshpërimit me kumtin e imazhit të sforcuar nga intensiteti ideoemocional i zërit të rrëfimtarit, i cili e prodhon situatën pikërisht nga çasti i lumturisë ("Neta ishte në ballkon duke i dëgjuar pëllumbat"), për të vazhduar më tutje në dekompozimin e raportit midis ëndrrës dhe realitetit, aty ku fuqizohet ironia, alegoria, paradoksi, sarkazma, si dhe temë-dilema çka do të ndodhë më tutje, nga ato fanitje të riprodhuara në botën e personazhit, nisur nga përshkrimi i faktit se koha e sundimit dhe detajet e së kaluarës hedhin dritë mbi fabulën kryesore të romanit, për ta fuqizuar praninë e paralelizmit figurativ midis dy kohëve, midis dy realiteteve, pastaj përbrenda gjendjeve shpirtërore të personazheve, në pikëvështrim me imazhin iluzor të ekzistencës apo për ta kuptuar esencën e mesazhit dhe moralin e një shoqërie njerëzore.

Virion Graçi është njëri ndër prozatorët më të shquar në prozën e sotme shqipe, i cili e faktorizon dokumentaritetin e së kaluarës me realitetin e përditshëm shqiptar, prandaj procedimi narrativ, figurativ dhe stilistik në këtë roman bazohet në ndjesinë e poetikës së përveçme. Argumentimi më i saktë, mund të paraqitej në rrafshin semiologjik: *gjysmëvëllai*, *këpucët*, *flamujt e bardhë*, pastaj përbrenda konvencionit kohor: *fundviti '91*, si dhe në projeksionin e besueshëm narrativ midis reales e imagjinares, rubrika: *koha për të folur*. Këto janë vetëm disa pika referimi të narracionit, filluar nga shenjat e kombinimit dokumentar e të përvojës jetësore midis situatave dhe veprimeve, që e formësojnë përfytyrimin mbizotërues të tematikës kryesore në romanin "Pëllumbat i vrasin natës".

Kodi i dyfishtë që e funksionalizon dimensionin poetik e figurativ të esencave të romanit karakterizohet edhe me përbërës të tjerë, të cilët e karakterizojnë fabulën e romanit, siç janë: *fijet e këputura të kujtimeve*, *soditjet gratis*, *shumimi i ëndrrave*, *punishtja e ëndrrave optimiste*, etj. Nga ky princip narrativ, strukturohet bota dhe vizioni i personazheve drejt zbërthimit të një periudhe të ekzistimit të qenies njerëzore e kombëtare, ku ideologjia dhe përkrahësit e saj përfytyrohen përbrenda një kornize konceptuale të sistemit që e përkufizon lirinë, sipas masës së tyre.



Kujtesa historike si alegori

Po kështu, romani i Virion Graçit, është roman i qartësimit të situatave narrative në kontekstin letrar dhe estetik. Narratori e formëson shtratin tematik të ngjarjes, i ndikuar nga pozicioni dhe perspektiva e Netës. Për më tepër, Neta e shpalos historinë e jetës, të dashurisë, por edhe të vdekjes, për të ndërtuar aktin e frikës e të torturës deri në shformësimin e pamjeve dhe paranojave që mbindërtohen për të, si dhe në iluzionin e personazheve të tjera.

Kësoënyre, kodi narrativ i romanit shpërfaqet në relacionin midis narratorit, Netës dhe Vegimit, për të saktësuar kohën e përshtatshme për intrigë dhe veprim. Ky është pikëshikimi psikologjik nga fillon thurja dhe të shthurja e dramës shpirtërore të personazheve dhe shkallë-shkallë formësohet konceptimi i tërësishëm i filozofisë së romanit.

Në strukturën e romanit ndërtohen një varg e vistër detajesh, situatash, ngjarjesh, monologësh, dialogësh, etj., siç janë: prania e halucinacionit, torturat ndaj Bekimit, portretizimi i Netës, pastaj sfondi vijues narrativ: burri i pushkatuar dhe fëmija e braktisur, krimet politike për interesat e klasës sunduese, ora e edukimit, shpëlarja e trurit, ironia e imagjinatës së shëndetshme krijuese, etj., sa që në rrafshin e kërkimit të intrigës romanore, ekzistenca kolektive projektohet përbrenda një realiteti social, kulturor, politik, i cili e prodhon paradoksalitetin dhe absurditetin e intelektualit: "burri i Netës-armik, ajo-vejusha e armikut, foshnja-djali i armikut".

Përshkrimi i ambientit të figurshëm është esenca e zbulimit të vërtetësisë së ndodhur, meqë Neta tipizohet si grua me kujtesë të gjymtuar, prandaj i vetmi ngushëllim i saj, është kujdesi për pëllumbat në ballkon, ndërkaq Djali i Braktisur, pra Vegimi, i përmbahet kërkesës për ta shpjeguar deri në fund misterin e pushkatimit të babait dhe gjetjen e eshtrave të tij.

Prova e së vërtetës funksionalizohet përbrenda situatave të përzishme në roman. Për të shpjeguar dhe konkretizuar domethënien e tekstit narrativ, paragjykohej çuditërisht modeli i shpifur me epitetin armiku i popullit: burri (Bekimi), gruaja (Neta) dhe djali (Vegimi), të cilët simbolizojnë kohën dhe hapësirën, bashkë me aktantet e tyre, duke shpalosur kujtesën historike dhe fatin e nëmur të brezave të ndryshëm të shoqërisë shqiptare, si në diktaturë, po ashtu edhe në postdiktaturë.

Romani "Pëllumbat i vrasin natën" tregon qartë për atdheun e shkrimtarit, i cili përfytyrohet dhe shpërfytyrohet në dy pamje: shpjegimi narrativ i një realiteti të përjetuar si një ëndërr e keqe, pastaj fati tragjik i njeriut, i cili ballafaqohej me diktaturën nëpër udhën e procesit të zbërthimit të kësaj drame shpirtërore, e cila strukturohet përbrenda trekëndëshit: nëna (Neta), babai (Bekimi) dhe i biri (Vegimi). Kjo është substanca nga zbërthehen detajet, situatat dhe të ndodhura në këtë roman.

Dashuria fatkeqe prodhohet nga kurthi i

torturave dhe masa e një ideologjie, duke krijuar dashurinë e imponuar në një rend të ri psikologjik të torturës shpirtërore dhe të një diktati sistematik e të imponueshëm. Intriga e rrëfimit sikur e zhvesh mitologjinë e një dashurie, duke këpur përgjysmë zgjedhjen e saj (Neta dhe Bekimi) dhe duke krijuar një dashuri artificiale (Neta dhe Metani). Në roman nguliten dhe funksionalizohen dy shtresa semantike e figurative të gjendjeve dhe veprimeve të personazheve. E para, është iluzioni si metafiksion dhe e dyta, është faksioni si dokumentaritet. Midis të dyjave, shpërthejnë herë ironia, herë alegoria, në relacionin narrativ dhe kuptimor, pikërisht në pozicionin e kombinuar narrative: dhënie-marrje dhe anasjelltas.

Virion Graçi e tematizon dhe problematizon dokumentaritetin përmes formave të thjeshta të epikës, duke ndërtuar metarrëfimin për realitetin, dukuritë, fenomenet, ekzistencën, jetën, dashurinë, fatin, torturën, vdekjen. Në procesin e krijimit të situatave kundërthënëse, personazhi i njohur si Djali i Braktisur (Vegimi), bëhet shenjë identifikuese në funksionalizimin e porosisë së romanit. Kapërthurja e reales strukturohet pikërisht përbrenda këtij dimensioni të idesë kryesore të romanit, meqë thelbi i zbërthimit të situatave dhe ngjarjeve, i nënshtrohet procesit të kapërcimit të botëkuptimit në botëpërjetim, pastaj pikëpjekjes së dokumentaritetit me realitetin, duke zgjeruar kufijtë e imagjinares përtej kohës së përjetuar, madje si absurditet dhe si alegori narrative.

Gjetja e eshtrave të babait për Vegimin, është fundi i tragjicitetit në këtë roman. Këtu zbërthehet çasti i një drame shpirtërore gati për një gjysmëshekull. Klithja e Vegimit: "Ba, i thashë, jam djali yt, jam Vegimi, *vegimi* jam *vegimi* yt", dëshmon për një tipar tjetër karakterizues në prozën e Virion Graçit, siç është biseda me të vdekurit. Këto shenja të dhimbshshme në relacionin babë-bir, tashmë e përmbyllin gjendjen dhe veprimin e personazhit. Poenta qëndron tek testamenti i kujtesës, para së gjithash, tek akti i zbulimit të eshtrave të Bekim Butinës, i cili shkruante poezi për dashurinë dhe për trishtimin e liqenit. Gjithsesi, përfundimi qëndron edhe tek morali dhe tek mendësia e postdiktaturës.

Virion Graçi e ka shkruar këtë roman, duke fuqizuar dimensionin dhe domethënien e një kujtese dokumentare, mbase edhe ngjashmërinë me njerëzit realë, të cilat në vetvete e formësojnë ironinë e një kohe dhe të një diktature nën ombrellën e së cilës përcaktohej ekzistenca dhe fati i njeriut. Proceset e jetës të kushtëzuara ideologjikisht, nuk e kanë frymën e vet autentike, prandaj është e arsyeshme përmbysja e rrjedhës dydimensionale të ngjarjeve dhe veprimeve, për të arritur deri te efekti letrar dhe estetik.

Në romanin "Pëllumbat i vrasin natën", vija tjetër narrative, e cila konceptohet midis Netës dhe Metanit, e projekton *metafiksionin historiografik* (term i Linda Hutcheon), për të ndërtuar një rend të ri të përjetimit të lumturisë, duke kujtuar fatkeqësinë e ndodhur, pastaj të përfytyruar në botën e ndërlikuar shpirtërore të Netës, gjithsesi, një realitet i imponueshëm, i cili në mënyrë ironike shëmbëllen me kontekstualizimin e figurës simbolike të pëllumbave në rrjedhën e ngjarjeve përbrenda romanit. Prandaj, këtu sprova e dashurisë së vetëzgjedhur shndërrohet në provë të dashurisë së imponuar. Kjo prani kundërthënëse në strukturën e romanit "Pëllumbat i vrasin natën", shenjat e veçanta i funksionalizohen në kuadër të kohës dhe hapësirës së caktuar, pikërisht përmes dy atributeve-simbole, që sjellin të panjohuren dhe kobin (*nata dhe vrasja*) dhe me një shenjë-simbol që nënkuptohet përmes konceptimit të lumturisë (*pëllumbat*). Kujtesa e fikur me dëshirë, është raport problematizues i rrëfimeve dhe ngjarjeve në rrjedhën e romanit. Është pra, kujtesa e fikur e Netës, si shenjim i shqiptimit të dramës shpirtërore në variantet e saj

Virion Graçi në romanin "Pëllumbat i vrasin natën", ka arritur t'i paraqesë me një invencion të rrallë, në radhë të parë, kujtesën historike si alegori dhe përvojën jetësore si ironi, duke i thyer konvencat e mentaliteteve të shoqërisë, kryesisht përmes distancës kritike. Ky roman mbase mund të përkufizohet s me emërtimin roman i personazhit, në të cilin diktatura bëhet referim i një kohe të ndërlidhur me mëkatin dhe i një ambienti të ndërlidhur me torturën. Kësisoj, mëkati i pabërë dhe tortura e ndodhur, e zbulojnë aventuër narrative të procesit shkrimor të romanit, që nga fillimi deri te përmbyllja e thurjes së ngjarjeve dhe veprimeve.

Romanet e tilla, sikur romani "Pëllumbat i vrasin natën", i Virion Graçit, me ndjenjën e shkëlqyer të receptimit, ofrojnë përgjigje të qarta dhe të sakta se veprat me shenjëzime të tilla letrare, kulturore, estetike, etj., jo vetëm që e pasurojnë një letërsi kombëtare, por pa dyshim bëhen edhe pikë referimi për zhvillimin e saj.

(Vijon nga fq. 11)

LIBRI AKTUAL
I DIKTATURAVE QË PËRSËRITEN
(nga pasthënia e Dr. Liviu Lungu)

Visar Zhiti i takon asaj race të personaliteteve, të cilat e imponojnë veten natyrshëm, kësisoj, pa sforco, pa tamtame, me një fjalë të drejtpeshuar, nëse është e nevojshme, me një gjest, me një vështrim, me një shaka të stërhollë. Vepra e Visar Zhitit, bën pjesë ndër ato krijimet më të rëndësishmet të rezistencës anti-diktatoriale dhe anti-false-demokratike, shkrimtari imponohet po aq natyrshëm, përmes drejtpeshimit dhe qartësisë së fjalës së shkruar, pa "Inteligjencë të huajtur", pa shpërthime, pa goditje të kota. Por si artikulimi ashtu edhe shkrimi janë të dyja jashtëzakonisht të mprehta, dhe nganjëherë të domosdoshme, si shprehje e fuqive të pazakonta të vëzhgimit dhe analizës; cilësi e lindur, e lëmuar falë përvojës për kaq shumë viteve, nga më tragjiket. Derisa të kaloni tek biografia e autorit, pothuajse arrini të njihni, përmes vargut dhe frazës, epopenë e disidentit.Unë këmbëngul në diçka që më duket e jashtëzakonshme: Vepra e Zhitit dhe vetë autori janë vendosur larg, shumë larg çdo qëndrimi dhe ligjërimi (copëza ligjërimesh) hakmarrës, të paktën me mungesë urrejtjeje. V. Zhiti është i lindur për të mos manifestuar ndjenja rudimentare-primitive. Zhiti, ai vetë, dhe poezitë e tij dhe proza e tij nuk kanë pikë urrejtjeje; është karakteristikë e personazheve të mëdhenj, të heronjve të vërtetë, të atyre që jetojnë shumë më dendësisht thellësitë dhe ëndrrat.(…)Por krijimtaria e Visar Zhitit, poetit dhe prozatorit, është shumë, shumë më e gjerë sesa nënkuptohet duke e thjeshtuar vetëm në "letërsinë e protestës". Edhe më përfaqësuese, sipas meje, është poezia e dashurisë tek Visar Zhiti. Unë guxoj të them se, në thelb, Zhiti është një krijues lirik/ erotik, një fakt i lehtë për t'u identifikuar edhe në romanin "Funeral i pafundëm", edhe nëse toni dominues i të gjithë tekstit është ai i një afresku shoqëror të amplitudës së pashembullt dhe duke mënjanuar çdo kompromis. Dhe, nëse në temat e "anti-diktaturës", "anti-gënjeshtrës" dhe "anti-hipokrizisë" Zhiti, vazhdimisht i kujdesshëm, thellë në embrion, megjithëse ai njeh sensin e masës, i pa rrëmbyer nga pasioni ose i nxitur nga ndonjë pasion armiqësor rudimentar, në vargje dashurie dhe në fragmentet lirike të prozës është aq i thellë dhe aq i përkushtuar. Në veprën e Visar Zhitit ekziston diçka e ndershme ("lojë e ndershme"), diçka besnike ndaj vetvetes, ndaj veprave të tij, ndaj mjedisit qoftë ai dhe armiqësor dhe ballë lëçitësit. Çfarë kundërshtari këmbëngulës, në praninë e tij dhe në vepër, mund të ketë çdo regjim i absurdit (diktatura personale, diktatura e të paktëve dhe sidomos të zgjedhurve, pra e të vetë-zgjedhurve ...)? "Funerali i pafundëm" është shembulli më i plotë i atyre që përmenda më sipër. Libri "Funeral i pafundëm" i marrë, në tërësi, po, është një metaforë. Metaforike janë gjithashtu mjaft nga episodet e tij. Dhe është gjithashtu një krijim simbolist. Por pasuria e jashtëzakonshme e momenteve që e kompozojnë atë, e konjukturave, e temave të ngritura në hijen e temës qendrore (prapa dhe nën hijen e arkëmortit) e nxjerrin romanin nga çdo kategori e inkuadruar në konceptimet teorike rutinë. Libri nuk ka protagonistë. Në të vërtetë nuk ka karaktere. Nuk është e nevojshme; masa e pjesëmarrësve nuk duhet të ketë as fytyrë dhe as maskë. Masa amorfe e njerëzve çojnë në rrugën e fundit ... Kë? Çfarë? Një gri e errët është sovrane në kortezh. Fizionomitë janë të rralla, shfaqen në mënyrë sporadike, më shumë në rigresione dhe të sapo skicuara. Heshtja është gjithashtu e fortë, motër binjake ndaj murmuritjes dhe zhurmës së ritmit që shkaktohet ose jo. Ka edhe zhurma, varësisht nga rrethanat, por tingujt e vërtetë vijnë edhe nga kujtimet. Dhe nga historitë e pëshpëritura, qofshin ato të shprehuara dhe me zë të lartë.

Libri rendit në kolonë një univers, universin e thatë, të butë, të helmuar të varrosjes së atij që nuk ka jetuar. Dhe marshimi i shoqëruesve të arkëmortit, me të gjitha kanunet e kaq shumë viteve, duket, në disa vende, si marshim i të vdekurve të pa kallur në dhe. Drama e popullsive të disa vendeve, drama e gjysmës së globit, drama e të gjithëve, me sa duket, paraqitet me veçoritë e territorit shqiptar. Aty ku, me siguri, morën format më mizore e më dramatike të shekullit. Por rrëfimi i Visar Zhitit është gjithashtu një pikëçuditje shumë e fortë. Një paralajmërim "anti-diktaturë", "anti-fals", "anti-hipokrizi" ...Dhe kush mund të jetë më i besueshëm se një kundërshtar i tillë këmbëngulës, në prani dhe në vepër, të çdo regjimi absurd (diktatura personale, diktatura e të paktëve dhe veçanërisht e zgjedhurve, domethënë e vetë-zgjedhurve ...)?Për sa kohë kërcënimi i përsëritjes së diktaturave më të urryera njerëzore është i mundshëm, ky libër mbetet aktual gjithmonë!"

Përktheu nga origjinali
Dr. Luan Topçiu

KANË THËNË PËR ROMANIN
«FUNERALI I PAFUNDMË»

Romani "Funerali i pafundme" është prozë ndryshe. Në momente të ngre temperaturën gjatë leximit, ngjashëm me faqet e prozës së Orvellit, kur ben fjalë për torturat ndaj kundershtarëve politike... Pse gjithe ky trishtim, sikur të paskesh qenë paluar nëpër shekuj, e për t'u shpaluar pastaj në faqet e romanit "Funerali i pafundme"?

Ali Aliu
Studiues, kritik arti, Prishtinë

Zhiti ka shkruar një vepër origjinale sa moderniste po aq edhe postmoderniste për nga konceptimi dhe ekzekutimi artistik si dhe mesazhi filozofik. Ky roman mund të krahasohet denjësisht me disa nga veprat më të mira të autorëve si Kafka, Orwell, Salinger, Heller dhe Solzhenitsi. Duke pasur parasysh historinë e romanit shqiptar, "Funerali i Pafundmë" është një arritje jo e vogël për letërsinë dhe kulturën shqiptare.

Dr Gëzim Alpion
Universiteti i Birminghamit, Angli

Visar Zhiti ndërton një mozaik marramendës, ku duket se janë vënë të gjitha me ngjyrat e ndjenjave : dhëmbja dhe ironia, seksi dhe ëndrra, vuajtja dhe bukuria, gjëmimet e luftrave në Ballkan dhe fantazmat, realja e përzier me jorealen duke u bërë më reale, përditshmëria e shpërndarë nëpër kohë, me një dënduri dhe harmoni që e arrijnë vetëm mjeshtrit.

Elio Miracco
Kritik arti, përkthyes arbëresh, Itali.

Funerali surreal që përshkruan Zhiti përballon temën më shumë se aktuale të konfliktit Vetvete – Ego që dominon shoqërinë e sotme postmoderne, temën e domosdoshmërisë së shembjes së skemave të konsoliduara antropologjike që i japin njeriut të sotëm disa përsigurime, por jo siguri të vërtetë (që vetëm fitohet e nuk dhurohet) në të jetuarit, temën e konflikteve që sjell konfuzioni konceptual mbi nevojat dhe sentimentet në dëm të këtyre të fundit.

Dr. Marko Solomom
Shkencëtar hebre

Visar Zhiti është shkrimtari shqiptar, jeta dhe vepra e të cilit mbase janë pasqyra më e mirë e historisë së kombit të tij...

Robert Elsie
Kritik arti, albanalog kanadezo-gjerman

Skicë nga Bujar Kapllani

Ndjenja e kohës

poezi nga

GIUSEPPE UNGARETTI

Përktheu nga origjinali: Aida Baro

Giuseppe Ungaretti është një ndër poetët më të mëdhenj italianë të shekullit XX. I konsideruar si babai i rrymës së hermetizmit, poeti gjithnjë ka pasur si qëllim atë që ai e quan "la poesia pura" (poezia e kulluar), poezia në vetvete e lidhur ngushtë me natyrën dhe shpirtin njerëzor.

"Ndjenja e kohës" është vëllimi i tij i dytë me poezi, botuar për herë të parë më 1933. Nëse në vëllimin e parë Allegria di naufragi (1919), ai theu të gjitha kanonet e përcaktuara të poezisë, metrikën, strukturën, leksikun, mendimin, duke e kthyer atë në një koncentrat të thukët dhe shpërthyes, ku me pak rreshta mëton të japë një gjendje të tërë shpirtërore e njerëzore, në këtë vëllim të dytë, ai i rikthehet poezisë së Giacomo Leopardi-t dhe Francesco Petrarca-s, stilit të përpunuar, leksikut të lartë thuajse klasik e hyjnor. Tashmë siç shkruan dhe vetë Ungaretti: "Unë rilexoja përulësisht poetët, poetët që këndojnë. Nuk kërkoja vargun e Jacopone-s apo atë të Dante-s, as atë të Petrarca-s apo të Guittone-s e të Tasso-s, as të të Cavalcanti-t apo të Leopardi-t: tek ata kërkoja këngën [...] këngën italiane, kërkoja këngën e gjuhës italiane në qëndrueshmërinë e saj përgjatë shekujve, përmes zërash kaq të larmishëm, me timbre kaq të ndryshme dhe shumë të kujdesshëm për risinë e tyre, zëra tepër të veçantë në shprehjen e mendimeve dhe të ndjenjave: ishte rrahja e zemrës sime që doja ta ndieja në harmoni me rrahjen e zemrës së më të mëdhenjve të një toke fort të dashur."

Poezitë e përzgjedhura këtu i përkasin periudhës së parë të pas Luftës së Dytë Botërore, (1919 – 1927), ku poeti fillon të meditojë edhe më thellë për fatin e tij, por jo vetëm individualisht, por të qenies njerëzore në përgjithësi. Përkohësia e njeriut mbi dhé përkundër përjetësisë vërehet qysh në poezinë "O natë", ku përmes metaforës së fuqishme të natyrës dhe stinëve, poeti shfaq trishtimin dhe melankolinë e tij të pafund. E njëjta ndjesi të krijohet edhe në poezinë "Peizazh" (1920) (100-vjetori i kësaj poezie), që shoqërohet dhe nga misteri, atë mister që poeti rreket ta rrokë e ta hedhë në poezi derisa në mbrëmje, gjendet i vetëm dhe i vetmuar dhe mund ta shfaqë hapur lodhjen dhe zhgënjimin e tij.

Poezia "Kujtim i Afrikës" na shpie në vendlindjen e poetit, i cili, i lindur në Aleksandri të Egjiptit, nga prindër italianë, kaloi fëmijërinë dhe rininë e hershme, pra pjesën kryesore të formimit të tij në Afrikë. Shkretëtira e paskaj me ngjyrat dhe tingujt e saj ka mbetur thellësisht e gdhendur brenda tij.

"Ujdhesa" mbetet një prej poezive më të errëta të Ungaretti-t, e vështirë për t'u deshifruar, se ç'është ky vend, ky ishull ku nuk dihet se kush zbret, ndoshta poeti vetë, ndoshta frymëzimi, ndoshta muzat? Poezia simboliste franceze gjen shprehjen e vet më të lartë në këto vargje. "Ujdhesa" është një peizash jashtë kohës, një përzierje e reales dhe ëndrrës, që në njëfarë mënyre kthehet në një interpretim metafizik të jetës dhe artit.

"Lindja e aurorës" është një tjetër poezi me shumë rrafshe e Ungaretti-t. Në fakt, në kuptimin e parë, përkthimi do të ishte "Lindja e agut (agimit)", mirëpo duke qenë se "aurora" nuk përfaqëson vetëm agimin e ditës së re, por edhe vashën e qashtër që dashuron poeti, aurora (e cila në fjalorin e shqipes ekziston me të drejta të plota) i përmbush të dyja kriteret e lojës së poetit, duke mos e vënë në vështirësi zgjedhjeje shumë të madhe përkthyesin. Ajo çka ndryshon në fund të poezisë është peizazhi, por ai ka si referencë edhe figurën femërore, butësinë e së cilës poeti e ka imagjinuar pështjellë në mantelin e qiellit.

Sidoqoftë, përshkrimet që kemi dhënë më lart janë veçse ndjesi të përkthyeses dhe i mbetet lexuesit tanimë të rrëmojë symbyllur në shpirtin e poetit, sepse në fakt, poezinë e Ungaretti-t, nuk mundet thjesht ta lexosh, por duhet të mbyllësh sytë e ta përfytyrosh çdo fjalë e çdo varg, atëherë do ta ndiesh plotësisht e thellësisht kuptimin e saj.

O NATË
1919

N'angështinë e paanë të agut
Larohen tej kurorat.

Zgjime sëmbuese.

Gjethe, motra gjethe,
Ofshamën tuaj mbaj vesh.

Vjeshtra,
Shende të mekura.

O rini,
Posa ka shkuar koh' e ndarjes.

Qiej të lartë të rinisë,
Hov i lirë.

E tash shkretì jam.

Tretur në të kërrusurën brengë.

Por nata davarit largësitë.

Heshtje oqeanike,
Fole yjore ëndërrimesh,

O natë!

PEIZAZH
1920

Ag
Ka një kurorë mendimesh flladitëse,
Feks në ujin e lulëzuar.

Mesditë
Male të tkurrura në rrjedha ujëpakë dhe shkretëtira
pushtuese drithëron padurimesh madje dhe gjumin turbullon
madje dhe statujat turbullohen.

Mbrëmje
Tek përflaket i bie më të që është e zhveshur, e ndezura
bojëtrëndafil në det e blertë e errët bëhet,
po s'është veçse sedef.
Kjo valë turpi ndër sende zbulon veç për një hop,
duke përligjur kështu melankolinë njerëzore,
tretjen e paskaj të gjithçkaje.

Natë
Tërësej është ndehur, zbutur, trazuar.
Fishkëllima trenash të ikur.
Ja tek shfaqet, se dëshmitarë nuk ka më,
edhe fytyra ime e vërtetë, kapitur e zhgënjyer.

KUJTIMI I AFRIKËS
1924

Kurrë më tani mes fushës pa kufir
Dhe detit pa anë s'do vetmohem, as të përvuajtur
Prej epokash të lashta, s'do ndiej të treten tingujt,
Të qashtër, në ajrinë e kthjellët; as më
Hiret e paarrira nuk do t'i zbulojë
Dhe në trajta përrallore nuk do t'i lëvdojë
Kjo fantazi marroke,
As Dianës veshur me petk drite shpuzë
Që shfaqet nga e rralla palmishtë,
Nuk do t'i rend pas
(Kryelartë, n'akullsinë e vet verbohej,
Po paskaji i kadifenjtë
Ia ndiqte sytë atje ku i hidhte
Gjakime orëzeza duke përzhitur,
Përngaherë).

Veç vijë e avullt është deti
Që dikur tërbim e harbim ish,
Dhe kupë mjalti, jo më i shijuar
Për të mos vdekur etje, më duket
Fusha, dhe i përkori gji i Dianës hir
Opalesh, as lehtas
Nuk regëtin.

Ah! Ky çast err e shuan kujtesën.



UJDHESA
1925

Te një breg ku e përjetshme ish mbrëmja
Me të moçme selvi mendimtare, zbriti,
Dhe thellë kuturisi
Në beh e zu fëshfërim' e flatrave
Që nga regëtima e çjerrë
E ujit të zhuritur u ngrit,
E një vegullí dalloi (aty venitej,
Aty gjallohej);
Tek ngjitej sërish pa
Që nimfë ish ajo e më këmbë
Flinte, me vidhin qafuar.

Vetmevete tek endej nga përhitja
Në shpuzë të gjallë, në një lëndinë shkeli ku
Hija në të virgjëreshave sy
Nanuritej si
Mbrëmja rrëzë ullinjve;
Rigonin kurorat
Një shi të plogët rrezesh,
Dhentë koteshin
Nën të butën ngrohtësirë,
Të tjera savanin e përndritur
Nduknin;
Duart e bariut, qelq i
Lëmuar nga eth' e mekët.

LINDJA E AURORËS
1925

Me petkun e butë e brerore,
Syfshehur,
Plot shpoti, ngjan se të grish,
E prej gjirit,
Të zbehtën lulethëngjill
Zhvesh e hedh, e dëlira natë.

N'atë çast ndahet më e para bardhëllimë
Nga më e fundit drithërimë.

Në t'qiellit zgrip, e irnosur vorbullën gris.

Me gishtërinj të smeraldtë
Valë të vagullta thurin
Pëlhurë.

E të praruarat hije, tek heshtojnë të gjallat
Psherëtima të vetvetishme,
Në vilarë të hollë i kthejnë hullitë.

Galja
tregim nga
THOMA NOTE

Kishte aq shumë rrudha fytyra e saj sa, po të mos shihje cigaren, tymi i së cilës gjallonte, fare mirë mund ta merrje për maskën e ndonjë indigjeni të ulur para zjarrit imagjinar të magjive mistike. Rrinte ashtu, kërrusur mbi një stol, me bërrylat mbështetur mbi këmbët e veta si shkarpa, me shikimin e një të verbri tretur diku larg. Më krijonte një lloj drithërime ai trup kockë e lëkurë mbështjellë nga një fustan basme, kur i kaloja përbri. Dhe isha i detyruar të përjetoja përditë atë ndjesi të pakëndshme...

Harrova t'u them se atë verë të mbrapshtë, kur nga çdo tarracë pallati kërcisnin kallashët e mitrolozët, për një sërë rrethanash të çuditshme, për të cilat nuk ia vlen të zgjatem këtu, shërbeja si shofer kamioni, që kishte për detyrë të çonte përditë një grup prej njëzet a tridhjetë grash e fëmijësh në plazhin e pishave të buta të Golemit. Ishte idiotizmi dhe papërgjegjshmëria më e madhe që kam provuar, por, kur e kujtoj, do të doja t'i rijetoja edhe një herë ato ditë.

Në fakt nuk ishte detyrë. Ishte punë vullnetare në kuptimin më të mirëfilltë të kësaj fjale. Ishte një çmenduri. Ishte çmenduri të kaloje me shpejtësi te "postblloku" prej dy blloqesh betoni, sajuar diku aty para se të kaloje Plepat, për të bërë plazh...

Por le të kthehemi aty ku e kishim fjalën.

Një ditë vura re se plaka, të cilën me zor e mbanin këmbët, po ngjitej në karrocerinë e "Benzit" tim, e ndihmuar nga nusja e djalit, të vdekur tashmë prej vitesh, dhe e mbesa.

Po atë, ku e çoni!? – pyeta jo pa çudi dy femrat.

E po ja, kishte qejf të vinte me ne edhe nëna, se mërzitet vetëm kur ikim ne.

Do bëjë plazh me ne? – pyeta gjithë qesëndi.

O, mos u tall dhe ti! E ke problem ti nëse makina do mbajë tridhjetë kile më shumë?

Jo. Jo. – nuk e zgjata unë dhe hyra në kabinë.

Kur arritëm në plazh, e pashë përsëri plakën që zbriti zdruq zdruq nga makina, siguristh mbështetur te krahët e nuses së djalit dhe të mbesës, por në vend që të shkonte drejt plazhit si gjithë të tjerët, erdhi pas meje te lokali ku pija kafen e mëngjesit. Nuk mjaftoi kjo, por, pa më marrë leje, m'u ul edhe në tavolinë...

"Oh, pik' e zezë! Hajde duro edhe këtë tani!"...

Kisha dëgjuar se ishte emigrante italiane, e martuar në kohë që s'mbahen mend me një rus të bardhë dhe se e kishte ndjekur atë bashkë me rusët e Fan Nolit deri në vendin tonë, por vetëm kaq dhe gjithë këto më dukeshin përralla.

Por unë kam një filozofi, që edhe në situatat më të pafavorshme mundohem të gjej diçka interesante, prandaj vendosa ta verefikoj saktësinë, ose më saktë, përqindjen e së vërtetës në morinë e thashethemeve.

I fola italisht.

Dy zjarre të vegjël u ndezën në sytë e saj. Nuk ishte e nevojshme ta nxisja të rrëfehej. Më foli për fëmininë e saj në një familje intelektuale italiane, për shkollën e zonjusheve që kishte ndjekur, ku mësimet i bënin frëngjisht... E atë çast mu ndez edhe mua një dritëz në mendje. Për ta provokuar, fillova t'i flas frëngjisht dhe, për habinë time, ajo e vazhdoi bisedën në një frëngjishte të rrjedhshme, pa e vënë re se e kishim ndryshuar gjuhën në të cilën po flisnim. I mrekulluar po vëreja se kisha para meje personazhin femëror të tregimit "Lumturia" të Mopasanit, me mish e me kocka... ndonëse kockë e lëkurë...

Po. Po. Ishte më tepër se një personazh letrar. Ishte fantazma e një tjetër kohe. Si mund të lija pa e zhbiruar!?...

Por nuk ishte e nevojshme. Sytë e saj kishin marrë flakë. Kush e di prej sa kohësh më kishte pritur!...

Në fakt, nuk isha unë Ai që ajo kishte pritur. Ajo kishte pritur dëgjuesin ideal, atë që i fliste gjuhën e nënës e të moshës së ëndrrave, dëgjuesin që nuk të ndërpret ndërsa tjetri flet e nuk të gjykon, dëgjuesin që bëhet pjesëz e jetës tënde, duke e pranuar të tillë si është...

Po ku shkuan rrudhat e saj? Si nuk e kisha vënë re më parë sa e bukur ishte?...

Ia thashë. Sytë e saj lëshuan fishekzjarre.

Atëhere m'u rrëfye për gjëra që do të më vinte turp t'i ritregoja. Jo se ishin të turpshme. Më tregoi për lumturira e lemerira të tilla, që më bënin të ndihesha si një nxënës shkolle...

Ishte shumë pak ajo ditë, për të treguar një jetë...

Kemi bërë tridhjetë e tre udhëtime në Golem atë vit; i kam numëruar. Nuk mbaj mend se në cilin prej tyre Galja erdhi për herë të parë, por di që udhëtimet me praninë e saj, ishin më të bukurit.

Pas asaj dite të parë, kur shpirti i Galjas shpërtheu si një ujvarë, pas kafes e bisedës me të, kur shtrihesha në plazh e shihja jetën si vrullonte rreth meje, kur shihja trupin e bukur të femrave që s'donin t'ia dinin për luftën që zhvillohej pak më tej, për të kapur kohën e humbur... gjithkush në luftë për të kapur kohën e humbur, kuptova... Kuptova se jeta është çasti. Se jeta është ai çast, me një kafe midis meje e Galjas; se është ky çast që po shkruaj... Se jeta është çasti midis meje dhe atij gjoksi të bukur femëror që, megjithëse ndodhej disa centimetra larg syve të mi, megjithëse i dëshiruar për t'u prekur nga një dorë mashkulli... do të mbetej i paprekur... i dëshiruar në pafundësi, duke lënë pas vetëm ndjesi...

Dhe erdhi dita, kur nuk mund të shkonim më në plazh. Jo se nuk donim. Jo se nuk e kishim mundësinë. Jo. Erdhi vjeshta....

E, megjithse vjeshtë e vonë, unë nuk mund të rrija pa takuar Galjan...

Shkoja përditë atje te ndërtesa e saj dhe i fishkëlleja, si adoleshent i dashuruar...dhe ajo, me hap të lehtë e me kujdes, zbriste ato katër-pesë shkallare të katit përdhes, për të ardhur në takim.

Më vjen të qaj, kur e kujtoj. Cila e dashur ka ardhur drejt meje me aq dëshirë e me aq delikatesë?... Cila e dashur ka lënë aq dëshirë për t'u ritakuar, pas shfrimit seksual?...

I kam edhe sot e kësaj dite kasetat me këngë italiane, të cilat ia kishin dërguar të afërmit e saj pas gjysëm shekulli ndarje dhe ajo m'i fali mua në një nga ato ditët, kur të gjithë e kishin kuptuar se plaka kishte rënë në dashuri me një dyzetetëvjeçar. Po bëhej gazi i botës dhe s'e kuptonte... Dritaret e gjashtë apartamenteve hapeshin thuajse njëkohësisht dhe mëse dymbëdhjetë sy e ndiqnin nga pas, ndërsa ajo hynte vjedhurazi te kafeneja, ku e priste "jarani"...

"Pu pu pu pu pu! O Zot, mos përfundofshim kështu!"

Ndërsa"Jarani", i vetëdijshëm, e priste me buzëqeshjen e zakonshme dhe lulen e freskët, që kamarieri nuk harronte kurrë t'ua vendoste në një gotë qelqi mbi tavolinë, dhe porosiste dy kafe. Ajo ulej përballë tij, e shihte në sy e lumturuar, duke gjerbur gjithë lezet llumin e trashë të kafesë turke që i kishte mbetur...

Ah, po, ka qenë dhe një puthje e dhënë nxehtësisht në faqe, fshehtazi atje te shkallët, ato ditë kur më dhuroi kasetat me muzikë italiane të viteve shtatëdhjetë. E ndjeva, se do të kishte dashur të putheshim në buzë... por kjo ishte përtej virtuteve të mia...

Pastaj erdhi dimri dhe ajo u sëmur. E kishin shtruar në spital...

E mora vesh vonë. Shumë vonë. Madje mësova se më kishte kërkuar.... Por, nuses së djalit, nipit e mbesës u kishte ardhur turp të më thoshin...

Ma treguan vetë, shumë vonë, po ata që ishin ruajtur se mos u humbte nderi.

Çfarë nderi?

Kujt do t'i humbte nderi?...

Hëna hyn në dhomën time

cikël me poezi nga

XHELAL TOSKU

* * *

vendi i sirenave është deti
ti përse këtu në tokë

* * *

O.
është lulja e bajames
që ra në kopshtin tim
qysh prej kohësh që nuk mbahen mend
as fjala nuk i thotë dot të gjitha
kështu që askush kurrë
nuk do e marre vesh
sa e desha

* * *

hëna vjen në dritaren time
hëna hyn në dhomën time
ullishten e kopshtit tim
e praron hëna në të gjelbër
portokajt në oborrin tim plot dritë hëne
edhe lëkura jote
po të zbrisja në hënë
hënën do t'a humbisja përgjithmonë
me ty ndodh ndryshe.

* * *

shtëpitë qielli
retë lart mbi det
deti dhe një guackë deti
askujt nuk mundem dot t'i them lamtumirë

* * *

për fatin tim të keq dhe shkakun tënd sot
përfundova në tavernë
të shkretën dhimbjen time thashë
ta mbys me verë

e poshtër kjo bote sa s'ka
e gjtha për shkakun tend
në mendje vetëm flokët e tu të verdhë
dhe kjo dhimbje që të sosur nuk ka

* * *

qiej dhe yje

si një dru pylli
dhe si era
zëri im therret trupin
tënd

frymë merr i gjithë universi

* * *

si një dru ulliri
mbrëmjeve pres
të vije era

si një fije terfili
mëngjeseve pres
të vijë shiu

dhe netëve
të artën hënë
unë pres.

që nën plepat e bardhë
nën brugat poshtë në fushë
lumi im
të ndrijë

matanë gardhit
një njeri
pret dhe ai

që unë me
të mos zgjohem.

* * *

qetësia vjen prej yjeve.

sado i thellë
të jetë deti

edhe peshku
edhe peshkatari
e di fatin e vet.

* * *

rri e rri
me orë të tëra mbi hekurudhë
m'paska marrë malli
me ndigju nje fërshellimë treni
kësisoj njeriu paskam qënë
unë

* * *

zogu në luginë

nga lugina
në pemë

pema me duart
tek unë

shpirti yt
dhe shpirti im

do fluturojnë
nëpër qiej.

* * *

katundi im
ku janë thanat buzë perroit
ku është rruga që të çon në shtëpinë time
po shtëpia ime ku është

* * *

në erresirë kur katundi humb
kur zë të bjerë i ftohti shi
që larg ndjehet një hingëllimë
një hingëllimë gjithë trishtim
e të vetmes pelë

e zeza pelë e katundit tim.

* * *

unë nuk kam autobiografi
jeta ime është e vockël
sa një kokërr meli
e mori milingona
dhe e futi në dhe'

Faslli Halitit

Ike miku im pa një shenjë
pa një lamtumirë
më dhimsesh sa ska
nuk do ta shohësh më qiellin e madh të Myzeqesë
as grunjërat as barin e gjelbër
as netëve hënën si pjepër
Pse nuk ndenje dhe pak
u lodhe u mërzite ta nxinë jetën
Fshatarët tanë ishin te mençur kur të thanë:
Ç›tu desh poema ty, o Faslli.
Më në fund tani do bëjnë gjumë të qetë
të gjithë ata që nuk të deshen
Pse nuk ndenje dhe pak, o miku im
Jo se do ndryshoje botën
ti këtë e dije mirë,
edhe kur thoje: lufta bëhet për të vërtetën
U lodhe miku im, kaq shumë u mërzite këtu që ike?
Me ndje miku im edhe unë herë herë isha me ty
më ndje, herë herë të kam lënë vetëm
Ike miku im
pa një shenjë pa një lamtumirë
Më thuaj të vërtetën ,
ti e di që te ty kisha shumë besim,
ta hapi apo nuk ta hapi portën vdekja?

* * *

o Noe, në atë varkën tënde të vogël
a ka ndonjë vend për Xhelalin

Përpara krismës së pushkës

tregim nga

NADINE GORDIMER

Fituese e Çmimit Nobel në Letërsi 1991

Marais Van der Vyver-i qëlloi me armë njërin prej punonjësve të fermës së tij, dhe e la atë të vdekur në vend. Një aksident. Aksidente të tilla me armë ndodhin çdo ditë të javës – ka fëmijë që, sot, luajnë lojëra fatale me revolverin e babait në qytete ku armët janë sende shtëpiake, por ka edhe fatkeqësi gjuetie si kjo, në provincë – veçse ato nuk pasqyrohen në shtypin botëror. Van der Vyver-i e di se rasti i tij do të bëjë bujë. Historia e fermerit Jug-Afrikan me origjinë evropiane – kryetar i partisë rajonale dhe kreu i komandos së sigurisë vendore – qëllon me armë një të zi i cili punonte për të, dhe kjo do t'i vijë për shtat versionit me të cilin *ata* do ta paraqesin Afrikën e Jugut, sepse kjo iu shërben më së miri. Ata do ta shfrytëzojnë këtë në fushatat e tyre të bojkotimit dhe të shpronësimit, dhe kjo do të jetë një tjetër dëshmi e së vërtetës, sipas këndvështrimit të tyre, për vendin. Gazetat në vend do ta citojnë ndodhinë ashtu siç ajo u pasqyrua në shtypin e huaj, dhe në atë vardisje, ai dhe zezaku do të kthehen në dy figura të vizatuara pa finesë në banderola kundër aparteidit, një argument ky pra, në funksion të statistikave dhe brutalitetit të të bardhëve kundër të zinjve që do të përmendet në Kombet e Bashkuara – do të përmendet ai, të cilin ata do të kenë mundësinë ta quajnë me ngazëllim 'anëtar i kryesisë' së partisë në pushtet. Kushdo që i përket komunitetit fermer e kupton sesi mund të ndjehet ai. Mjaft keq, sepse ka vrarë një njeri, por ai, ama, nuk ka ndihmuar as armiqtë e partisë, dhe as të qeverisë apo të atdheut. Ata e kuptojnë se kjo është e vërtetë. Ata e dinë, sepse i lexojnë gazetat e së dielës, dhe se kur Van der Vyver-i citohet se ka thënë që është 'shumë i tronditur,' ai 'mendjen e ka te gruaja dhe fëmijët,' se asnjë amerikan apo anglez, dhe askush nga vendasit që duan ta shkatërrojnë pushtetin e të bardhit nuk do ta besojë atë. Dhe do ta përqeshin për atë që ai thotë (sipas një gazete, nëse mund të besohen korrespondentët e saj), se 'Ai ishte miku im, gjithmonë e merrja me vete në gjueti.' Banorët e qytetit, si dhe ata që jetojnë jashtë shtetit, nuk e dinë nëse kjo është e vërtetë apo jo: fermerët zakonisht mbajnë një djalë zezak që pëlqejnë ta marrin me vete në pronat e tyre; atë mund ta quash një lloj shoku, po, sepse shokë nuk janë vetëm njerëzit e tu të bardhë, si edhe ju, të cilët i ftoni në shtëpi, dhe me të cilët luteni në kishë apo punoni së bashku në komitetin e partisë. Po si mund ta dinë të tjerët këtë? Ata as që duan ta dinë, dhe madje janë të mendimit se të zinjtë janë si ata agjitatorët gojëlëshuar në qytet. Këtu bën pjesë edhe fytyra e Van der Vyver-it, në fotografitë që çuditërisht u bënë publike për shkak të fatkeqësisë – por, gjithkush në rajon e mban mend Marais Van der Vyver-in si një djalë të vogël, i cili e kishte zakon të largohej dhe të fshihej nëse të kapte duke i buzëqeshur, dhe tani, të gjithë e njohin si një person që fsheh çdo ndryshim të shprehësisë përqark syve si edhe gojës nën një mustaqe të trashë e të butë, tek hedh shikimin në sende që mban në dorë, siç mund të jetë një gjethe e një bime të lashtë, një stilolaps apo një gur që ka gjetur diku, dhe këto, në momente përqendrimi kur dëshiron të flasë ose kur dëgjon. E gjitha kjo dëshmon se çfarë të shkakton tronditja; dhe kur ti vetë i vështron fotografitë nëpër gazeta, të krijohet përshtypja se po kërkon ndjesë, a thua se je duke i zgurdulluar sytë në një dhomë ku nuk duhej të ishe.

Hetim do të ketë; dhe është mirë që të ketë, për t'i dhënë fund supozimit se ky është një tjetër rast i brutalitetit ndaj punëtorëve të fermës, edhe pse nuk ka asnjë dyshim – se bëhet fjalë për një aksident për të cilin Van der Vyver-i i ka pranuar plotësisht të gjitha faktet. Me të mbërritur në rajonin e policisë me kufomën në karrocerinë e kamionit të vogël, ai bëri një deklaratë. Kapiteni Beetge, sigurisht, e njeh mirë atë; madje i ofroi dhe një konjak. Ai, i biri trupmadh, gjakftohtë, dhe i zgjuar i Willem Van der Vyver-it, që kishte trashëguar fermën më të mirë të të atit, dridhej si purteka në ujë. Djaloshit të zi e të pajetë nuk mund t'i vije më në ndihmë. Beetge nuk do t'i thotë askujt se pas konjakut Van der Vyver-i qau. Ai qau me ngashërim, hundët i rrodhën dhe i ndotën duart, si të ishte një fëmijë i bërë pis. Për shkak të tij, Kapiteni u bë me turp, ndaj dhe u largua për t'ia dhënë atij rastin që ta rimerrte veten.

Marais Van der Vyver-i doli nga shtëpia në orën tre të pasdites për të vrarë një antilopë të madhe, të familjes kudu, të cilën ai e mbron në zonat pyjore të fermës së tij. Ai tregon interes për kafshët e egra, sigurimin e mishit të gjahut, si edhe rritjen e numrit të bagëtive që e shikon si detyrën e shenjtë të fermerëve. Si zakonisht, ai u ndal tek ofiçina e tij me qëllim që ta merrte me vete Lucas-in, punëtorin e fermës njëzetë e një vjeçar, i cili kishte treguar prirje për mekanikën; vetë Van der Vyver-i e kishte mësuar Lucas-in si t'i mirëmbante traktorët dhe makineritë bujqësore. Ai i ra borisë së makinës, ndërsa Lucas-i ndoqi rutinën e zakonshme duke u hedhur në karrocerinë kamionit. Atij i pëlqente të udhëtonte në këmbë mbi karrocerinë e kamionit tek përpiqej që gjahun ta shquante para se këtë ta bënte punëdhënësi i tij. E kishte bërë zakon të përkulej përpara, i mbështetur te tavani i kabinës që ndodhej disa pëllëmbë më poshtë.

Van der Vyver-i kishte një karabinë dhe një municion prej treqind fishekësh në kamion. Karabina i përkiste babait të tij, sepse e tija ishte dërguar te dyqani i armëtarit. Që nga vdekja e babait (rreshteri i Beetge-s shkroi 'që kur babai u nda nga jeta') armën nuk e kishte përdorur askush, ndaj kur ai e nxori atë nga një raft, ishte i sigurt se ajo nuk ishte e mbushur. Armë të mbushur, babai nuk kishte lejuar kurrë në shtëpi; atë vetë e kishin mësuar në fëmijëri që asnjëherë të mos e ngiste makinën nëse kishte me vete armë të mbushur. Por ja që kjo armë qëlloi të ishte e mbushur. Në një rrugë të pashtruar, Lucas-i goditi fort me grusht tre herë tavanin e kabinës për ta dhënë sinjalin: shiko majtas. Meqenëse kishte parë rrathët bardhë e të valëzuar mbi trupin e një kudu, si edhe brirët e tij të hollë me ndihmën e të cilëve ai kërkonte ushqim në gëmushat e dendura, Van der Vyver-i e kaloi makinën me shumë shpejtësi mbi një gropë në mes të rrugës. Troshitja e kamionit provokoi krismën. Pushka shikonte vertikalisht në drejtim të tavanit të kabinës në një vijë të drejtë me kokën e Lucas-it. Plumbi, pasi përshkoi pjesën e sipërme të kabinës, nëpërmjet fytit, u fut drejtpërsëdrejti në trurin e tij.

Kjo është deklarata që u bë për atë çka ndodhi. Pavarësisht nga pozicioni i tij shoqëror në rajon, Van der Vyver-it iu desh të kalonte përmes procedurës së betimit se gjithçka që ai tha ishte e vërtetë. Çdo gjë, pra, e thënë zyrtarisht është regjistruar dhe do të mbetet në arkivat e stacionit të policisë rajonale për sa kohë që Van der Vyver-i të jetë gjallë, dhe për më tepër, deri në fund të jetës së fëmijëve të tij, Magnus-it, Helena-s dhe Karel-as – për deri sa situata në vend nuk përkeqësohet, shembulli i bandave zezake në qytet nuk ndiqet në zonat rurale dhe rajoni i policisë nuk shkrumbohet siç ka ndodhur me shumë rajone policie në qytete të ndryshme. Sepse, asgjë që do të bëjë qeveria nuk mund t'i qetësojë agjitatorët dhe të bardhët, të cilët i shtyjnë ata. Asgjë nuk i kënaq ata nëpër qytete: të zinjtë nuk mund të ulen dhe të pinë në hotele që frekuentohen nga të bardhët, por tani, kur Ligji i Imoralitetit është hequr, të zinjtë mund të flenë me të bardhët....Dhe kjo, nuk përbën më asnjë lloj krimi.

Rreth shtëpisë dhe kopshtit të tij, Van der Vyver-i ka vendosur një gardh sigurie prej telash me gjemba, për të cilin, gruaja e tij, Alida, është e mendimit se ai e prish plotësisht efektin e rrëkesë artificiale të hijeshuar me bimët e fierit nën pemët jacaranda. Aty ndodhet dhe një antenë që ngrihet lart si një shtizë flamuri në oborrin e pasmë. Të gjitha mjetet, përfshirë edhe kamionin e vogël në të cilin zezaku humbi jetën, janë të pajisura me antena të cilat koloviten sa herë që shoferi e hedh mjetin në një gropë: ato bëjnë pjesë në sistemin e sigurisë që fermerët kanë vendosur në rajon, dhe që bën të mundur mbajtjen e kontaktit midis të gjithë fermave njëzetë e katër orë në ditë. Ka ndodhur tashmë që, persona të ardhur apostafat përtej kufirit, të vendosin mina përgjatë rrugëve që të çojnë në ferma të largëta, dhe kështu, t'ua marrin jetën fermerëve të bardhë dhe të familjeve të tyre, në rastet kur ata dalin për piknik të dielave. Rënia në një gropë të rrugës mund ta kishte shkaktuar edhe shpërthimin e një mine që mund ta kishte lënë të vrarë Van der Vyver-in bashkë me djaloshin e fermës. Kur fqinjët përdorin sistemin e komunikimit për t'u lidhur me radio, dhe për të thënë se iu vjen keq për 'atë çështjen' e djaloshit të Van der Vyver-it, nuk është e nevojshme të thuhet se: punët mund të kishin shkuar shumë më keq.

Bie në sy, duke marrë parasysh cilësinë dhe pajimet e arkivolit, se fermeri ka dhënë një shumë lekësh për ceremoninë e përmortshme. Dhe një ceremoni e përgatitur me kujdes ka një domethënie të madhe për të zinjtë. Ja shikoni pak, sesi ata e zhveshin veten edhe nga ato pak gjëra që kanë në jetë, me qëllim që t'i përballojnë shpenzimet kundrejt shoqërive të varrimeve për të mos përfunduar kështu në një arkivol të bushtë dhe në një varr pa emër. Bashkëshortja e tij e re është shtatzënë (sigurisht) dhe një tjetër vogëlush, i cili ka veshur një palë këpucë të kuqe tepër të

(Vijon në fq. 19)

EUDORA WELTY

Si më krijuan prindërit një fëmijëri me libra

Mësova aty rreth moshës dy ose tre vjeçe që çdo dhomë në shtëpinë tonë, në çdo kohë të ditës, ishte aty për të lexuar ose për të të lexuar. Nëna më lexonte. Më lexonte çdo mëngjes në dhomën e madhe të gjumit, pasi uleshim në karrigen lëkundëse, e cila krijonte ritëm ndërsa tundeshim, sikur të kishim një bulkth që shoqëronte historinë. Më lexonte në dhomën e ngrënies, pasditeve të dimrit, para zjarrit të qymyrit, me orën që binte me tingullin si të qyqes që i jepte fund historisë me "Qyqe", dhe natën kur isha në shtrat. S'duhet t'a kem lënë të qetë. Ndonjëherë më lexonte në kuzhinë duke tundur dybekun, dhe zhurma dëneste bashkë me *çdo* histori. Ishte ambicia ime ta bëja që të më lexonte ndërsa *unë* tundja dybekun; një herë ma plotësoi dëshirën, por ajo e mbaroi së lexuari historinë për mua para se të bëhej gjalpi. Ishte një lexuese shprehëse. Për shembull, kur po lexonte "Macja me çizme", ishte e pamundur të mos e dinte që ajo s'u besonte të *gjitha* maceve.

Kishte qenë befasuese dhe zhgënjyese për mua kur zbulova se librat me histori ishin shkruar nga *njerëzit*, se librat nuk ishin mrekulli natyrore, që dalin vevetiu si bari. Megjithatë, pavarësisht nga kishin ardhur, s'mund të kujtoj një kohë kur nuk isha e dashuruar me to - me vetë librat, ballinën, letrën me të cilën ishin shtypur dhe si ishin lidhur, me erën dhe peshën ndërsa e mbaja në dorë dhe e merrja me vete. Akoma e pashkollë, isha gati për to, e përkushtuar për të gjithë leximet që mund t'u bëja.

Asnjë nga prindërit e mi nuk i përkiste një shtëpie që kishte mundësi të blinte shumë libra, por megjithëse duhet të ketë qenë e vështirë me pagën që merrte si oficeri më i ri në një kompani të re sigurimesh, im at zgjidhte dhe porosiste me kujdes ato libra me të cilët ai dhe nëna mendonin se ne fëmijët duhet të rriteshim. Ata blinin libra para së gjithash për të ardhmen.

Përveç raftit të librave në dhomën e ndenjes, e cila gjithnjë quhej "biblioteka", në dhomën e ngrënies kishte një tryezë me enciklopedi dhe një raft me fjalorë. Për të na ndihmuar të rritemi duke debatuar rreth tryezës së dhomës së ngrënies ishin fjalori Webster, Enciklopedia e Columbia-s, Enciklopedia e illustruar e Compton-it, dhe enciklopeditë Biblioteka e Informacionit e Linkolnit dhe më vonë Libri i Njohurive. Kur u zhvendosëm në shtëpinë tonë të re, kishte vend për ta përuruar me botimin e ri të eciklopedisë Britannica të vitit 1925, të cilin im at, ishte i prirur ta mendonte si një libër më të mirë se çdo botim i mëparshëm.

Në "bibliotekën", brenda raftit të thjeshtë, me tre dyer prej xhami me rrjetëz në formë rombi, me kolltukun e gjerë të tim ati dhe abazhurin në tryezën pranë, ishin librat që mund të filloja t'i lexoja së shpejti - dhe ashtu bëra, nisa t'i lexoj duke i marrë një nga një nga rreshtat në raft duke nisur nga lart-poshtë. Ishte Ligjërat e Stoddard-it, me fjalorin tipik të shekullit të nëntëmbëdhjetë, skicat të jetës së fshatarëve plot besime dhe zakone të çuditshme, me ilustrimet vizatimore përkatëse: Vezuvi që shpërthen, Venecia në dritën e hënës, ciganët ndanë flakëve të zjarreve. Atëherë s'e dija se ato shprehnin dëshirën e zjarrtë të tim ati për të parë pjesën tjetër të botës. Kam lexuar drejtpërdrejt përmes kësaj dashurie të tij për vende të largëta: Librin Victrola të Operës, me opera, përshkrime të tyre, illustrime me portretet e sopranove Melba, Caruso, Galli-Curci dhe Geraldine Farrar, zërat e të cilëve mund t'i dëgjonim në pllaka gramafoni.

Nëna ime kishte në plan të dytë leximin për informacion, ajo u zhyt si hedoniste në leximin e romaneve. E lexoi Dickens-in sikur po arratisej me të dashurin. Romanet e vajzërisë së që mbetën në imagjinatën e saj, përveç atyre të Dickens-it, Scot-it dhe Robert Louis Stevenson-it, ishin Jane Eyre, *Gruaja me të bardha, Pallate të gjelbërta, Minierat e mbretit Solomon*. Do të shfaqej edhe Emri i Marie Corelli-it, por e kuptova që s'ishte e prapëlqyer nga ime më, e cila e kishte ruajtur besnikërinë si lexuese vetëm për romain Ardath. Me kalimin e kohës ajo u zhyt në leximin e Galsworthy-t, Edith Wharton-it, para së gjithash katër vëllimet e *Xhozefi dhe vëllezërit* të Thomas Mann-it.

Romanim *Shën Elmo* të Jane Evans-it s'e kishim në shtëpinë tonë por e shihja shpesh në shtëpi të tjera. Ky roman jashtëzakonisht i njohur jugor është arsyea pse filloi të ketë vajza me emrin e heroinës së romanit, duke e mbushur me Edna Earles-a popullatën tonë. Të gjitha ato morën emrin e heroinës, e cila arriti të gjunjëzonte një mashtrues femrash, mëkatar dhe ateist si si Shën Elmo. Nëna arriti ta harronte. Por iu kujtuan këshillat që zakonisht u jepeshin atyre që kujdeseshin për trëndafilave gjatë kohës së pushimit: "Merrni një karrige për t'u ulur dhe një Shën Elmo".

U detyrohem prindërve për takimin e hershëm me Mark Twain-in, autor kaq i shtrenjtë. Kishte një komplet të plotë me librat e Mark Twain-it dhe disa

libra të Ring Lardner-it në raftin tonë të librave, dhe këto ishin vëllime që na bashkuan të gjithëve, prindërve dhe fëmijëve.

Duke lexuar gjithçka që kisha para meje hasa në një libër të vjetër që i përkiste babait tim kur kishte qenë fëmijë. Titullohej *Sanford dhe Merton*. Pyes veten, a ka mbetur vallë dikush që e ka lexuar? Ishte përralla e famshme morale e shkruar nga Thomas Day në vitet 1780, por për të s'përmendet asgjë në faqen e parë të këtij libri; aty ishin Sanford-i dhe Merton-i tek *Fjalët e Njërrokëshe* të Mary Godolphin-it. Aty ishin djali i pasur dhe djali i varfër dhe Zoti Barlow, mësuesi dhe bashkëbiseduesi i tyre, në ligjërata të gjata që alternoheshin me skena dramatike – gjendeshin në rrezik por shpëtonin të pasurit edhe të varfërit. Mund të kishte vetëm fjalë me një rrokje, por njëra prej tyre ishte "thonë". Përfundonte jo me një, por me dy mësime morale, të dyja të gdhendur në unaza: "Bëj atë që duhet, në çdo lloj rrethane" dhe "Para se të bëhemi të mëdhenj, duhet të mësojmë të bëhemi të mirë".

Këtij libri i mungonte ballina e përparme, pjesa e pasme kishte shirita letre të ngjitura, tani me ngjyrë të verdhë, fletët me njolla dhe të grisura në cepa; ilustrimet e mrekullueshme ishin shkëputur, por ishin ruajtur në secilën fletë. Edhe në fëmijërinë time të shkujdesur kam pasur ndjesinë se ky ishte libri i vetëm që babai si djalë i vogël kishte pasur të vetin. E kishte ruajtur dhe mund të kishte fjetur duke e vënë nën krye: nëna i kishte vdekur kur ishte shtatë vjeç. Babai s'na e kishte përmendur kurrë librin e fëmijërisë së tij, por e kishte marrë me vete nga Ohajo në shtëpinë e re dhe e vendosi në raftin tonë të librave.

Nëna kishte sjellë nga Virxhinia Perëndimore kompletin e librave të Dikensit, dhe ato libra dukeshin të trishtuar - kishin kaluar nëpër zjarr dhe provën e ujit para se të lindja unë, kështu më tha ajo, dhe ishin vënë në rresht - siç e kuptova më vonë, duke *më* pritur.

Me sa mbaj mend, u njoha me librat e mi, për ditëlindje dhe në mëngjesin e Krishtlindjes. Në të vërtetë, prindërit s'mund të më jepnin aq libra sa duhej. Duhet të kenë sakrifikuar për të më dhënë në ditëlindjen time të gjashtë ose të shtatë - pasi u bëra lexuese – kompletin me dhjetë vëllime të enciklopedisë *Bota jonë e mrekullueshme*. Këto libra ishin të bukur, të rëndë, shtrihesha në dysheme përpara vatrës së dhomës së ngrënies për t'i lexuar, dhe më së shumti para syve mbaja vëllimin e pestë të *Libri i historisë së çdo fëmije*.

Kishte përralla - Grimm, Andersen, anglezët, francezët, "Ali Baba me dyzet hajdutë"; aty ishin edhe Ezopi, Reynard Dhelpra; kishte mite dhe legjenda, Robin Hood-i, Mbreti Arthur, Shën Gjergji dhe Dragoi, madje edhe historia e Zhan D'Ark; rravgimet e *Përparimi i Pelegrinëve* dhe një pjesë e gjatë e Guliverit.

Të gjithë kishin ilustrime klasike. E mësova përmendësh përmbajtjen e këtyre faqeve dhe mund t'i hapja menjëherë aty ku ishin historitë dhe fotografitë që doja; shumë shpesh përralla "Xhuxhi i verdhë" ishte zgjedhja e parë, e përshtatur nga Walter Crane me ilustrime plot ngjyra që e bënin pamjen e tij të tmerrshme në shoqërinë e gjelave të detit. Tani ai vëllim është aq i konsumuar dhe kopertinën e pasme, e kishte të katandisur si *Sanfordi dhe Mertoni* i stërvjetëruar i tim ati. Faqet e çmuara me poezitë humoristike të Edward Lear-it kanë qenë të rrezikuara të griseshin nga përdorimi për vite të tëra. Një tregues i dashurisë time për *Bota jonë e mrekullive* ishte se për një kohë të gjatë vrisja mendjen nëse mund të kaloja nëpër zjarr dhe ujë për të siç kishte bërë nëna për Charles Dickens-in, dhe ngushëllimi i vetëm ishte të mendoja se mund t'ia kërkoja nënës ta bënte për mua.

Besoj se jam fëmija i vetëm që u rrit me këtë thesar në shtëpi. I pyesja të tjerët: "A e keni *Bota jonë e mrekullueshme*?" dhe u thoja se *Libri i Njohurive* as që i afrohej atij.

Jetoj me mirënjohje ndaj prindërve që më mbështetën, sapo ua kërkova, pa më lënë të prisja, për njohjen e fjalës, leximit dhe drejtshkrimit, me anë të alfabetit. Më mësuan në shtëpi të nisja të lexoja para se të filloja shkollën. Besoj se tani alfabeti nuk shihet më si një element thelbësor i pajisjes me dije për të udhëtuar nëpër jetë. Në kohën time ishte guri themelor i dijes. Mësoje alfabetin ndërsa mësoje të numëroje deri në dhjetë, siç mësoje lutjet, emrin e babës, nënës, adresën dhe numrin e telefonit, në rast se humbje.

Dashuria ime e përhershme për alfabetin, u shtua prej recitimit të tij, por, para kësaj, prej parjes së shkronjave në faqe. Në librat e mi me hsitori, para se t'i lexoja vetë, rashë në dashuri me gërmat e ndryshme dredha-dredha, me pamje magjepsëse të vizatuara nga Walter Crane në titujt e përrallave. Në "Një herë e një kohë, një "O" kishte një lepur që vraponte si në rrotë, me këmbët mbi lule. Kur erdhi dita, vite më vonë, që të shihja Dhiatën e Re, e gjithë magjia e shkronjave dhe e fjalëve më përfshiu me mijëra herë, dhe ndriçimi i shkronjave të arta, ngjante si pjesë e bukurisë së fjalës dhe shenjtërisë që kishte qenë aty nga fillimi.

Eudora Welty (1909-2001) u lind në Jackson, Mississippi, SHBA, Ka shkruar tregime, romane, ese, recensa dhe është fituese e Çmimit Komëbtar të Librit dhe Çmimit Pulitzer. Shkrimi është shkëputur nga "Fillimet e një shkrimtari", pjesë e leksioneve që mbajti në universitetin e Harvardit më 1983, të cilat u botuan si libër një vit më pas nga Harvard University Press.

Përktheu: Granit Zela



(Vijon nga fq. 17)

mëdha për këmbët e tij, qëndron i mbështetur në barkun e dalë të së ëmës. Ai është tepër i vogël për ta kuptuar atë që po ndodh, atë që ai po përjeton këtë ditë, ndaj as ankohet, por as lozonjar nuk është; ai është serioz, pa e ditur përse. Të zinjtë i ekspozojnë fëmijët ndaj çdo gjëje, ata nuk i pengojnë nga përballja me frikën dhe dhimbjen siç bëjnë të bardhët me fëmijët e tyre. Është bashkëshortja e re ajo që tund kokën sa majtas djathtas dhe ngashëren si një fëmijë, dhe qan me dënesë me kokën të mbështetur në gjoksin e një kushëriri apo të një tjetri.

Të gjithë të pranishmit, o punojnë për Van der Vyver-in, o janë familjarë të atyre që punojnë për të; gjatë sezonit të spastrimit të barërave të këqija apo të mbledhjes së të korrave, gratë dhe fëmijët punojnë për të gjithashtu, mbi kamionë – të mbuluara me batanije – ato këndojnë, që herët në agim, gjatë shpërnguljes së tyre drejt fushave. Nëna e të ndjerit, është një grua që nuk mund të jetë më shumë se diku aty te fundi i të tridhjetave (vajzat fillojnë t'i lindin fëmijët në moshën e pjekurisë seksuale); me trupin e saj të zhvilluar dhe e veshur me një fustan të zi ajo është futur midis dy prindërve, të cilët kishin kohë që punonin për plakun Van der Vyver, që kur Marais Van der Vyver-i, ashtu si edhe vajza e tyre, ishte fëmijë. Prindërit e mbajnë atë me duar sikur ajo të ishte një e burgosur apo një e çmendur që duhet frenuar. Kokën nuk e ngre lart; sytë nuk ia hedh as Van der Vyver-it, arma e të cilit krisi brenda kamionit, ndërkohë që shikimin ia ka hedhur varrit. Asgjë nuk ka për ta detyruar atë që të shikojë lart; frikë të mos ketë askush; se ajo do të shikojë në drejtimin e tij. E shoqja e tij, Alida, i qëndron pranë. Për ta treguar respektin e duhur, si në çdo ceremoni të bardhë varrimi, ajo ka zgjedhur një blu të fortë për veshjen, dhe një kapelë ngjyrë krem, të cilën e ka veshur në kishë këtë verë. Ajo gjithmonë e ka mbështetur të shoqin, edhe pse ai nuk duket se e vë re këtë; këtë indiferentizëm dhe përmbajtje – e ëma e tij thotë se, si fëmijë, ai kurrë nuk e kishte pasur të lehtë të krijonte marrëdhënie me të tjerët – ajo për vete e pranon këtë, por ndjen edhe keqardhje për faktin se indiferentizmi e pengoi atë ta hidhte kandidaturën, ashtu siç ishte e mira të bëhej, për përfaqësuesin parlamentar të partisë në zonën e tyre. Ai nuk lejon që teshat e saj, apo të kujtdo që ndodhet pranë tij, ta prekin. Edhe ai ia ka ngulur sytë varrit. Nëna e të ndjerit dhe ai vështrojnë varrin si të komunikonin së bashku, ashtu siç kishte ndodhur midis të ziut në karrocerinë e kamionit dhe njeriut të bardhë brenda kabinës, disa çaste para se arma të kriste.

Përpara se pushka të kriste, kishte pasur disa çaste emocionimi midis të riut me ngjyrë në karroceri dhe fermerit të bardhë brenda në kamion, emocionime që ndaheshin nëpërmjet tavanit të kabinës, nga ku do të kalonte edhe plumbi. Momente të tilla, të pashpjegueshme, kishte pasur midis tyre, ndonëse shpesh herë qëllonte që, në ambientet e fermës pronari i saj të përballej me të riun e të mos ia kthente përshëndetjen, si të mos e njihte fare atë. Kur plumbi doli nga gryka e pushkës, Van der Vyver-i pa se antilopa e madhe kudu, e trembur nga krisma, u pengua dhe më pas ia dha me të katra. Ishte pikërisht atëherë kur ai dëgjoi një zhurmë të mbytur pas tij, tek pa nga dritarja trupin e një të riu që binte nga makina. Ai ishte i bindur se, ashtu si edhe antilopa, ai ishte trembur, dhe në përpjekje për t'u hedhur nga makina kishte rënë keq. Fermeri gati sa nuk po qeshte me një ndjenjë lehtësimi, madje, kur hapi derën donte ta vinte të riun në lojë, ngaqë nuk kishte kurrsesi mundësi që plumbi të kalonte përmes tavanit të kabinës dhe ta godiste atë.

I riu, përkundrazi, nuk qeshi aspak me frikën që e pushtoi fermerin. Ky i fundit e mori të riun në krahë dhe e futi atë në kamion. Ishte i sigurt, i sigurt se ai ishte akoma në jetë. Por, gjaku i të riut me ngjyrë, tashmë, kishte njomur të gjitha rrobat e trupit të fermerit, i cili tek ngiste makinën ndjeu t'i njomet edhe trupi.

Si do ta marrin vesh ata, kur të krijojnë një dosje me copa letrash të prera nga gazetat, dëshmi, prova, kur t'i shikojnë fotografitë dhe ta vështrojnë fytyrën e tij – fajtor! fajtor! kanë të drejtë! – si do ta marrin vesh ata, kur rajonet e policisë të bëhen shkrumb e hi bashkë me të gjitha dëshmitë për atë që ka ndodhur dhe atë që ligji në të kaluarën e cilësonte si krim. Si mund ta dinë ata se *ata nuk dinë*. Asgjë. I ziu në moshë të re, i goditur me pandjeshmëri nga arma, për shkak të neglizhencës së njeriut të bardhë, nuk ishte djaloshi i zi i punësuar nga fermeri; ai, ishte biri i tij.

Përktheu: Aristidh Shqevi
12.11.2020, Oslo

Mehmet Kraja

SËMUNDJA E ËNDRRAVE

Trilogji për vendlindjen

OnufriRoman